



# KUVENDI

Revistë e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 25, mars 2010



## DY VJET PAVARSI



## Editorial



### Në prag festë

Dy vjet më parë, ne, dëshmitarët e lindjes më të madhe historike, madhërisht na lindi forca, besimi, bindja e njëkohësisht vendosmëria për t'u shkëputur përfundimisht, nga makthi i tmerrit dhe dhimbjes së thellë të së kaluarës dhe shpresa e madhe për ndërtimin e shtetit të ri, ku qytetarët të ndihen të lirë, të barabartë dhe të sigurt për të ardhmen e aspiratave të tyre.

Ky ishte ti, "NEWBORN".

"NEWBORN"! Në këtë prag festë, gëzimi, përkujtimi dhe meditari, kur akoma je foshnjë, kur akoma nuk i ke marrë mirë këmbët..., ke rënë në dilemën e kësaj prag feste se..., Ku ishim...?! Ku jemi...?! Ku do të shkojmë...?!

Në këtë prag festë, ti ke të drejtën tende legjitime të festosh sa më madhërisht, me fishekzjarr e hareshëm, të ndiesh gëzimin dhe lumturinë e jetës, ta ndiesh, ta shijosh dhe të dehesh me aromën dhe madhështinë e lirisë!?

Por kujdes "NEWBORN"...!

Në këtë prag festë, a do të belbëzosh ndonjë fjalë nderimi për ata qindra e mijëra burra e gra, të rinj e të reja dhe fëmijë, që ranë për tu bërë të pavdekshëm, për tu prehur në altarin e lirisë, apo do të belbëzosh për të ardhmen?

Vallë, a e ke kuptuar "NEWBORN", se liria dhe e ardhmja janë binom të njëra tjetrës.

Se pa liri edhe mund të mbijetosh, ashtu siç mbijetuam, madje për qindra shekuj. Por pa liri nuk mund të ndërtohet të ardhmen.

Kjo ditëlindje të thërret të nderosh veprën e atyre, që luftuan! Që u masakruan! Që dhanë jetën për lindjen tënde.

Të shprehësh mirënjohje për të gjithë ata njerëz të mëdhenj, burra shtetesh, për të gjitha ato shtete mike, të cilat kuptuan, pranuan dhe vendosmërisht vendosën që ti të lindësh, e të rritesh i mbarë.

Kujdes "NEWBORN" !

Ti linde në kohët moderne. Dhe kohët moderne kërkojnë vizione bashkëkohore, politikanë largpamës, qeveri programore, popuj tolerant dhe..., shtet të së drejtës.

### Pra kujdes!



*Petrit Subashi*

## Përmbajtja:

**Kosova e pavarur ka vizion të qartë drejt integritit euroatlantik (faqe 3)**

**Pavarësia është e pakthyeshme (faqe 5)**

**Kuvendi synon krijimin e infrastrukturës ligjore për funksionimin e Komisioneve Hetimore (faqe 6)**

**Puna dy vjeçare në legjislaturën e tretë (faqe 8)**

**Raport real (faqe 10)**

**Perspektivë evropiane për Kosovën, Strategji dhe Plan Veprimi për përballimin e sfidave (faqe 11)**

**OSBE vlerëson pozitivisht punën e Kuvendit (faqe 12)**

**Kosova konfirmohet si faktor stabiliteti në rajon (faqe 14)**

**Ndërtohen edhe tre komisione të tjera Parlamentare (faqe 15)**

**Për investime kapitale – 400 milionë euro (faqe 16)**

**Delegacioni Parlamentar i Kosovës merr pjesë në seancën parlamentare të Polonisë (faqe 18)**

**Hapa të sigurtë në ndërtimin institucional (faqe 19)**

**Vendosen parametra të qëndrueshëm dhe koeficientët logjik të pagave (faqe 20)**

**Të gjitha grupet parlamentare, PDK, LDK, AAK, AKR, LDD, dhe 7+ mbështetën në parim të dyja projektligjet (faqe 21)**

**Prin Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (faqe 22)**

**Zgjedhjet e suksesshme në Kosovën e pavarur (faqe 23)**

## Këshilli Botues:

*Gjylnaze Sylja, Vladimir Todorović,  
Berat Luzha, Mursel Halili,  
Armend Zemaj, Ismet Hajrullahu,  
Njomza Emini, Shefqet Rexhepi,  
Synavere Rysha, Petrit Subashi,  
Shpresa Murati, Jenniffer Ober,  
Arta Qorri*

*Zyra për marrëdhënie me Media dhe Publikime e  
Kuvendit të Kosovës  
Redaktor: Petrit Subashi*

# DY VJET PAVARËSI

**Kthesa që bëri Kosova gjatë dhjetë vjetëve të lirisë dhe dy viteve të pavarësisë është e madhe dhe historike Mirënjohje e thellë ndaj botës demokratike, SHBA-së, Evropës, NATO-s dhe gjithë miqve të shtrenjtë të Kosovës anekënd globit**

**Përcaktim i qartë dhe i fuqishëm për integrimet euroatlantike**

**Zhvillimi ekonomik ka shënuar rritje vjetore rreth 4 për qind , që në këtë kohë krize globale, për Republikën e Kosovës është shumë domethënëse**

Në shenjë të krenimit të dyvjetorit të Ditës së Pavarësisë së Kosovës, sot u mbajt mbledhja solemne e Kuvendit të Republikës së Kosovës, kryesuar nga kryekuvendari dr. Jakup Krasniqi, në të cilën merrnin pjesë edhe presidenti i Kosovës, Fatmir Sejdiu, kryeministri Hashim Thaçi, kryesuesi i ICO-së Pitër Feit, kabineti qeveritar dhe përfaqësues diplomatik. Në fjalën e rastit, kryetari i Kuvendit , Jakup Krasniqi pasi përshëndeti të pranishmit, theksoi se dy vite janë pak për historinë, por kthesa që ka bërë Kosova gjatë dhjetë vjetëve të lirisë dhe dy viteve të pavarësisë është e madhe dhe historike. Kosova e popullit prej më të vjetërve të Evropës, ishte e humbur dhe e harruar dikur në hartën e zhbravitur të Ballkanit të konflikteve të përgjakshme. U deshën përpjekje e sakrifica të shumë brezave për ta bërë Kosovën shtet të pavarur e sovran, të njohur e të respektuar në katër anët e botës.

Në dy vitet e shtetndërtimit Kosova i ka ngritur të gjitha institucionet kushtetuese e demokratike të shtetit, e ka stabilizuar shoqërinë shumetnike dhe është bërë faktor paqej në rajon.

**PAVARËSIA ISHTE NJË NGA PARAKUSHTET E DOMOSDOSHME TË ZHVILLIMIT TË PËRGJITHSHËM TË KOSOVËS**



Duke radhitur disa nga rezultatet më të shënuara të legjislativit, z. Krasniqi tha se gjatë dy legjislativave të kaluara janë miratuar mbi 160 ligje, ndërsa vetëm gjatë këtyre dy viteve janë miratuar mbi 140 ligje, të cilat rregullojnë shtetësinë e Kosovës, përcaktojnë standarde të larta të mbrojtjes së të drejtave të minoriteteve dhe të drejtave e lirie themelore të njeriut, mundësojnë zhvillimin e gjithanshëm të vendit dhe hapin perspektivën integruese në Bashkimin Evropian dhe në institucionet tjera euroatlantike.

Kosova tashmë është anëtare e Fondit Monetar Ndërkombëtar, e Bankës Botërore, pjesëmarrëse në organizma, forume e iniciativa rajonale e ndërkombëtare dhe në rrugë të mirë për të hyrë në familjen e madhe të Kombeve të Bashkuara.

Pas mbrojtjes së shkëlqyer të së drejtës dhe legjitimitetit të shpalljes së pavarësisë në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë dhe pas shpalljes së mendimit të saj këshillëdhënës, presim që shpejt të shtohet numri i vendeve anëtare të OKB që do ta njohin pavarësinë e Republikës së Kosovës.

Pavarësia ishte një nga parakushtet e domosdoshme të zhvillimit të përgjithshëm të Kosovës. Kosova ka potenciale të shumta zhvillimi e përparimi, por nuk i mungon as mbështetja e solidariteti ndërkombëtar. Prezenca ndërkombëtare, civile dhe ajo e sigurisë, angazhimi i miqve tanë të shumtë për forcimin e vendit tonë dhe Konferenca e donatorëve e vitit 2008, e konfirmojnë përkushtimin e bashkësisë ndërkombëtare për Kosovën dhe popullin e saj.

Zhvillimi ekonomik ka shënuar rritje vjetore rreth 4%, që në këtë kohë krize globale, për Republikën e Kosovës është shumë domethënëse. Janë krijuar kushte të favorshme për investime të kapitalit të huaj në Kosovë, siç janë siguria e stabiliteti politik, infrastruktura ligjore e fizike, telekomunikimet dhe lehtësitë doganore e tatimore, sigurimi i një mjedisi të qëndrueshëm biznesi, të cilat bashkë me pasuritë e mëdha dhe potencialin rinor e fuqinë e lirë punëtore, do të tërheqin investime të huaja dhe do të mundësojnë zhvillim të shpejtë. Viti 2010 do të shënojë kthesë të rëndësishme në zhvillimin ekonomik të Kosovës.

Në vijim të përpjekjeve tona për konsolidimin e sistemit institucional dhe për vendosjen e rendit kushtetues në gjithë territorin e Republikës së Kosovës, ICO dhe Qeveria kanë hartuar Qasjen Gjithëpërfshirëse të veprimeve në veri të Kosovës, e cila është mbështetur gjerësisht nga politika e institucionet tona, por edhe nga bashkësia ndërkombëtare. Ka ardhur koha që në atë pjesë të Kosovës të fillojnë procese të reja integruese dhe prosperuese për të mirën e qytetarëve tanë atje, si në gjithë vendit tonë. Ne e ftojme Republikën e Serbisë, të mbajë qëndrim konstruktiv ndaj kësaj strategjie qëllimtare, t'i kontribuojë marrëdhënieve tona të mira e integruese evropiane, proceseve paqësore dhe dialogut pragmatik për çështjet e interesit të përbashkët. Kosova e pavarur është realitet i pakthyeshëm dhe integriteti i saj i garantuar ndërkombëtarisht, është i pacenueshëm. Komuniteti serb në Kosovë dhe komuniteti shqiptar në Serbi, duhet të na shërbejnë si ura të komunikimit e të bashkëpunimit reciprok.

Duke veçuar disa nga detyrat që shtrohen në të ardhmen kryekuvendari Krasniqi tha:” Vendi ynë ndodhet në sfida të vazhdueshme, si: ajo e njohjes së gjerë ndërkombëtare të pavarësisë, e anëtarësimit në OKB dhe organizata të tjera ndërkombëtare, e reformave demokratike, e përmblylljes së kornizës ligjore, e sundimit të ligjit dhe e luftës kundër kimit të organizuar dhe korrupsionit, e luftës kundër varfërisë dhe papunësisë, e rritjes dhe zhvillimit ekonomik, e procesit të privatizimit, e decentralizimit të plotë dhe e përkrahjes politike e financiare komunave të reja, e integritit të veriut dhe të gjithë serbëve në shoqërinë e Kosovës, e zbatimit të rekomandimeve të Raportit të Progresit të Komisionit Evropian, e përmbushjes së kriterëve të liberalizimit të vizave dhe të integritit evropian, e Objektivave Zhvillimore të Mijëvjeçarit, e përmirësimit të kapaciteteve administrative, e bashkëpunimit rajonal etj.

Kosova e ka shpallur pavarësinë dhe sovranitetin, prandaj duhet jetësuar plotësisht dhe në gjithë hapësirën e saj. Ne e miratuar Kushtetutën dhe ligjet, të cilat duhet respektuar e zbatuar rigorozisht, sepse duam shtet ligjor dhe demokratik. Ne i bëmë institucionet, të cilat duhet forcuar e

funksionalizuar, që të gëzojnë besimin dhe respektin e vazhdueshëm të qytetarëve, i bëmë strategjitë për fusha të ndryshme, të cilat duhet t’i vëmë në jetë. Ne jemi përcaktuar qartë dhe fuqishëm për integritet euroatlantike, prandaj të gjithë, shqiptarët shumicë, komunitetet pakicë, qytetarët dhe institucionet, shoqëria civile dhe mediet, çdo ditë duhet t’i shtyjmë përpara këto procese”.

Në këtë përvjetor të pavarësisë, theksoi na vazhdim Jakup Krasniqi, kujtohen me pietet të rënët e të gjithë brezave, që u sakrifkuan për liri dhe për Kosovën e re. “Sot përkulemi para kujtimit të lavdishëm të flijimit biblik të komandantit legjendar, Adem Jashari dhe familjes së tij, në Epopenë e Prekazit monumental. Ne u detyrohemi atyre përjetë, por edhe amanetit që na lanë”, theksoi kryekuvendari.

Në përmblyllje të fjalës së tij kryekuvendari Krasniqi u shprehu mirënjohje të thellë dhe falënderim të madh botës demokratike, SHBA-së, Evropës, NATO-s dhe gjithë miqve të shtrenjtë të Kosovës anekënd globit, të cilët ndihmuan atë në proceset e vështira e historike të çlirimit, të vendosjes së paqes dhe të ndërtimit të demokracisë e të rimëkëmbjes pas luftës shkatërruese.

## PAVARËSIA E KOSOVËS I KA SJELLË MË SHUMË PAQE DHE STABILITET RAJONIT

Në vijim, seancës iu drejtua presidenti i Kosovës , Fatmir Sejdiu, me këto fjalë:” Dy vjet më parë, përfaqësuesit e zgjedhur të popullit të Kosovës shpallën pavarësinë e Republikës së Kosovës, e cila është rezultat i punës, i sakrificave dhe i flijimeve të gjata të brezave të shumtë të Kosovës, si dhe i ndihmës së madhe të miqve tanë ndërkombëtarë, vendeve të Aleancës Veriatlantike dhe vendeve të tjera anekënd botës. Sot, kur kremtojmë dyvjetorin e pavarësisë së shtetit tonë të lirë, ne kujtojmë me mburrje ideatorin dhe arkitektin e Republikës së Kosovës, prijësin tonë historik dr. Ibrahim Rugova, i cili përhapri të vërtetën për Kosovën në të gjitha qendrat e mëdha të botës, në Uashington, në Bruksel, në Londër, në Paris, në Berlin, në Romë, në Ankara e gjetiu. Filozofia politike e Ibrahim Rugovës, fryma krejtësisht e veçantë e humanizmit dhe paqes që ai predikonte ishin diçka e re për këtë pjesë të Evropës e të botës, në të cilën përherë ka mbisunduar retorika e luftës dhe e urrejtjes. Urtësia dhe largpamësia e tij, në një kohë kur Ballkani Perëndimor po kalonte nëpër kalvare të tragjeditive apokaliptike, ndërgjegjësuan botën demokratike për rrezikun që i kërcënohej Kosovës dhe popullit të saj. Kjo filozofi politike dhe lufta çlirimtare e popullit të Kosovës për liri, me shembullin unikat të flijimit të familjes Jashari në Prekaz të Drenicës, bindën botën për drejtësinë e kauzës sonë, e cila u përkrah fuqishëm edhe nga NATO-ja, e cila në pranverën e vitit 1999 nisi fushatën e madhe për shpëtimin e popullit të Kosovës nga gjenocidi”, theksoi ai.

Duke folur rreth procesit të njohjes së Kosovës, ai tha se pavarësia e Kosovës është njohur nga 65 vende demokratike anekënd globit. Kosova ka vendosur marrëdhënie bilaterale me shumë vende të botës. Janë hapur 21 ambasada dhe 10 misione konsullore në vendet që kanë njohur dhe mund të thuhet se , për fillim, është arritur të ndërtohet një diplomaci solide, e cila po e përfaqëson me dinjitet vendin në botën e jashtme.

Gjithmonë në bashkërendim të plotë me vendet mike, me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me vendet kryesore të Bashkimit Evropian dhe me vendet e tjera mike, është punuar që të sigurohen sa më shumë njohje, në mënyrë që Republika e Kosovës të këtë vendin e saj në kuadër të familjes së madhe të kombeve të lira. Për këtë qëllim, është zhvilluar gjatë këtyre viteve një bashkëpunim i pashkëputur me miqtë e Kosovës , është lobuar te vendet që ende nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës, duke kërkuar nga vendet mike që ta përdorin influencën e tyre për ta mbështetur Kosovën në këtë proces të rëndësishëm.

Gjatë dy vjetëve të funksionimit si shtet i pavarur, është dëshmuar faqe botës se pavarësia e Kosovës i ka sjellë më shumë paqe dhe stabilitet rajonit. Republika e Kosovës, me politikën e saj të fqinjësisë së mirë, jo vetëm që është dëshmuar si një faktor i rëndësishëm i paqes, por edhe ka shërbyer si një katalizator i marrëdhënieve më të mira në mes vendeve të rajonit. Fatmirësisht, politika e fqinjësisë së mirë ka gjetur mirëkuptimin e plotë të vendeve fqinje. Tashmë Kosova ka marrëdhënie të shkëlqyeshme me Shqipërinë, me Maqedoninë, me Malin e Zi, si dhe me vendet e rajonit, me Kroacinë, me Slloveninë dhe me Bullgarinë. Megjithatë Greqia ende nuk e ka njohur pavarësinë e Kosovës, edhe me këtë shtet zhvillohet bashkëpunim intensiv.



Problem i vetëm në raportet me jashtë mbetet Serbia, e cila po e vazhdon politikën e saj agresive kundër Kosovës. Beogradi zyrtar po i financon strukturat paralele serbe, të cilat veprojnë në veri të vendit, ku ende ka shkallë të lartë të kontrabandës dhe të kriminalitetit ekonomik. Qindra-miliona euro janë investuar nga Serbia për mbajtjen e këtyre strukturave, të cilat po e mbajnë peng komunitetin serb në atë pjesë të Kosovës, duke mos i lejuar qytetarët e këtij nacionaliteti të integrohen në jetën institucionale dhe shoqërore të Kosovës për të mirën e tyre dhe të mirën tonë të përbashkët. Përkritazi me këtë ai shfaqti besimin se kjo gjendje atje do të marrë fund, ndërsa njerëzit duhet të kenë të drejtën e tyre për t’u kthyer në shtëpitë e tyre, serbët në jug, ndërsa shqiptarët, boshnjakët dhe të tjerët në veri, atë ku kanë jetuar me shekuj.

“Ne e kemi përkrahur strategjinë për veriu të Qeverisë së Kosovës dhe të Zyrës së Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar (ICO), e cila synon të sjellë normalitetin në këtë pjesë të vendit, në të cilën shumë vjet me radhë kanë vepruar të lirë individë e banda që i kanë shumë borxhe drejtësisë për krimet e kryera gjatë viteve të luftës në Bosnjë, në Kroaci dhe në Kosovë.

Po ashtu, mbështetje të plotë i kemi dhënë edhe përkushtimit të EULEX-it për ta ndihmuar funksionimin e rendit dhe të ligjit në Kosovë, një sferë kjo në të cilën na mbetet ende shumë punë për të bërë.

Kosovës i nevojitet një gjyqësor i pavarur, profesional, i ripërtërirë dhe

i reformuar. Për ta arritur këtë ky sistem ka nevojë për mbështetje të parazervë të institucioneve të vendit, por edhe të vetë qytetarëve, të cilët nuk duhet të ngurrojnë për të bashkëpunuar me mekanizmat që garantojnë ruajtjen e rendit dhe respektimin e ligjit në shtetin tonë, me Policinë e Kosovës, me gjykatat e me prokuroritë”, tha ai. Ndërkaq, në

vijim ai tha se madhështia e një kombi nuk matet me fuqinë e tij, por me mençurinë dhe besimin. “Nëse dimë të udhëhiqemi nga këto virtyte të larta njerëzore, nuk kemi pse të frikësohemi për atdheun që do t’ua lëmë trashëgim brezave tanë të ardhshëm”, pohoi presidenti Sejdiu.

## PAVARËSIA E KOSOVËS ËSHTË MERITË E ÇDO QYTETARI TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Kryeministri i Kosovës, Hashim Thaçi, tha se pavarësia e Kosovës është meritë e çdo qytetari të Republikës së Kosovës. Çdo qytetar duhet të ndihet krenar kudo që jeton, në Kosovë dhe diasporë, si qytetar, dhe si familje e si shoqëri.

Populli i Kosovës është krijuar i shtetit të Kosovës. Republika e Kosovës në dyvjetorin e shënimit të Ditës së Pavarësisë është shtet edhe më i konsoliduar, më i zhvilluar me institucionet stabile dhe efektive, me qeverisjen e mirë, sundim të rendit e të ligjit, me respektimin afirmativ të komuniteteve.

Për herë të parë në Kosovën e pavarur u organizuan zgjedhjet lokale ku qytetarët tanë në mënyrë të dinjitetshme dhe shumë krenare zgjedhën udhëheqësit e tyre lokalë. Ishin këto zgjedhje të lira, fer dhe demokratike që u vlerësua lart nga të gjithë.

Republika e Kosovës u bë anëtare me të drejta të barabarta në Bankën Botërore dhe Fondin Monetar Ndërkombëtar, ndërsa është afër anëtarësimit edhe në Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

Duke folur për disa aspekte të rimëkëmbjes ekonomike të Kosovës kryeministri Thaçi tha: “Me përkushtimin tonë të vazhdueshëm institucional

ne krijuam vende të reja pune, me paga më të mira. Ndërkohë, u ndërtuan qindra kilometra rrugë të reja dhe dhjetëra shkolla të reja, bëmë reforma të rëndësishme edhe në politikë, edhe në legjislacion, edhe në ekonomi. Jemi duke vazhduar kështu për të përmirësuar jetën e përditshme të qytetarëve, duke mundësuar një të ardhme më të mirë, më të sigurt për fëmijët tanë. Në ditët si kjo, duhet të nderohen dëshmorët tanë, ata që dhanë më të shtrenjtën për lirinë e vendit tonë, të respektohen heronjtë e gjallë të këtij vendi, veteranët, mësuesit e ditëve më të rënda që na mësuan se si duhet atdheu dhe liria, mjekët që na shëruan plagë, artistët që na pasuruan shpirtin, bujqit që punuan shumë, pensionistët që gjithashtu punuan shumë. Pra, të gjithë, të gjithë kontribuan në pavarësinë që ne e kemi sot”.

Në vazhdim kryeministri u shprehu falënderime të gjitha shteteve mike, mbështetëse të përpjekjeve për liri dhe pavarësi: Shteteve të Bashkuara të Amerikës, vendeve të Bashkimit Evropian dhe gjithë mbështetësve në përpjekjet për liri, pavarësi, e në procesin e njohjeve dhe ato integruese. Ndërkaq, duke folur për sfidat e së ardhmes kreu i ekzekutivit tha se ato janë zhvillimi dhe integrimi. Kosova do të integrohet në NATO dhe në Bashkimin Evropian. Sot po ndërtohet Kosova e përjetshme, Kosova krenare, Kosova e së ardhmes, theksoi kryeministri Thaçi.

## DUKE U PËRKULUR PARA KËTYRE BURRAVE DHE GRAVE, QË GJITHÇKA QË PATËN E DHANË PËR TË ARDHMEN TONË, NDEROJMË TË GJITHË BREZAT E DËSHMORËVE



Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, dr. Jakup Krasniqi, i shoqëruar nga anëtarët e kryesisë së Kuvendit dhe këshilltarët e tij, sot, në dyvjetorin e shpalljes së pavarësisë së Kosovës, ka bërë homazhe te varri i Komandantit Legjendar Adem Jashari, dhe ka vendosur një kurorë lulësh.

Në këtë rast, kryeparlamentari Krasniqi, 17 Shkurtin e ka cilësuar si ditë të shënuar dhe festën më të madhe për të gjithë qytetarët e Kosovës.

“Erdhëm për të vënë lule të freskëta mbi varrin e Komandantit Legjendar të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, për të nderuar familjen Jasharaj dhe të gjithë Jasharët, që për Kosovën hapën një epokë të madhe, epokën e lirisë, të pavarësisë dhe të demokracisë. Duke u përkulur para këtyre

varrezave, para këtyre burrave dhe grave, që gjithçka që patën e dhanë për të ardhmen tonë, ne i nderojmë të gjithë brezat e dëshmorëve, të gjithë ata që në forma të ndryshme kanë rënë për lirinë tonë, për ardhmërinë e fëmijëve tanë”, theksoi kryetari i Kuvendit të Kosovës.

Kryetari Krasniqi tha se edhe në shumë përvjetorë të tjerë, njerëzit e vdekshëm do ta kenë të vështirë ta çojnë në vend tërësisht amanetin e dëshmorëve.

“Për amanetin e tyre jemi duke u angazhuar, duhet të angazhohemi edhe më shumë, por për të çuar në vend atë, duhet të punojnë breza të tërë. Lavdi iu qoftë dëshmorëve!”, theksoi kryeparlamentari Jakup Krasniqi.

# Mesiq, ky mik i madh

**Kam ardhur në Kosovë si mik i shtetit të ri. Vij në kohën, kur Kosova kërkon vendin e vet në botë Do hyjmë në Evropë me rregulla të njëjta ligjore, me kufij të hapur, me liri të plotë të lëvizjes së njerëzve. Demokracia është shumë më shumë se kjo.**

*Krye parlamentari Krasniqi duke e vlerësuar z. Mesiq si një udhëheqës i dashur i popullit mik kroat dhe burrështetas i respektuar në botë, theksoi se presidenti Mesiq çmohet si mik i madh, i cili mbrojti në kohë të vështira të drejtat legjitime të popullit të Kosovës duke kontribuar për njohjen ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës, dhe për thellimin e marrëdhënieve*

*miqësore midis dy vendeve dhe popujve tanë. Kreu i Kuvendit vlerësoi se Republika e Kroacisë ishte një nga mbështetësit brilant të pavarësisë së Kosovës në procesin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në Hagë. Nën duartrokitjet frenetike kryetari i Kuvendit Jakup Krasniqi e ftoi z. Mesiq të marrë fjalën.*

## Kam Ardhur në Kosovë, si mik i shtetit të ri

Zotëri kryetar i Kuvendit të Kosovës, me kënaqësi të veçantë po ju drejtohem sot, me rastin e vizitës së parë zyrtare të një presidenti kroat, Republikës së Kosovës, anëtarëve të trupit më të lartë, përfaqësues të shtetit më të ri, jo vetëm në rajon, por edhe në Evropë, e njëkohësisht edhe shtetit të popullit më të vjetër të kësaj pjese të kontinentit të vjetër. Që në fillim, më duhet qartë të them se, vizita ime e Kosovës nuk është e drejtuar kundër askujt. Ajo, është vetëm në funksion të forcimit të marrëdhënieve tona bilaterale, por edhe stabilitetit dhe sigurisë në tërë rajonin. Kam ardhur në Kosovë si mik - i shtetit të ri, por edhe të gjithë qytetarëve të saj, edhe kosovarëve, edhe serbëve. Përsërisë : edhe kosovarëve, edhe serbëve! Qytetarë të Kosovës të nacionalitetit serb, dje kanë festuar Krishtlindjet. Unë do të shfrytëzoj këtë vend, që t'u uroj këtë festë të madhe dhe urimin tradicional "Hristos se rodi". Është koha e fundit që të kuptohet, në të gjitha anët, se e ardhmja është në bashkim, në bashkëpunim, në ndihmë reciproke, për shembull në kushtet e krizës ekonomike e cila na godit të gjithëve. Këtë dëshiroj të them qysh në fillim, sepse siç e dini në disa qarqe ka interpretime të ndryshme të vizitës time. Mirëpo, unë edhe këtu, si edhe në shumë vende të tjera, të cilat i kam vizituar në dhjetë vite të mandatit tim, kam ardhur vetëm e vetëm me një qëllim: të nxisë bashkëpunim të ndërsjellë, si në kuadër të bilaterales, ashtu edhe multilaterales, të ftoj në bashkëpunim i cili do të jetë në interes të të gjithë qytetarëve tanë.

## Vij në kohën, kur Kosova kërkon vendin e vet në botë

Vij në kohën kur Kosova ende me shumë mundime depërton në skenën ndërkombëtare, kur kërkon vendin e vet në botë, vend, i cili i takon, sepse çdo popull i takon e drejta për vetëvendosje dhe që të drejtojnë fatin e vet. Pozita kushtetuese-ligjore e Kosovës si krahinë autonome në ish Jugosllavinë ka qenë e zgjidhur në një mënyrë të veçantë, mënyrë e cila nuk gjendet askund në botë, kështu që është plotësisht e arsyeshme, kur thuhet që Kosova është rast sui generis. Kur interpretohet kushtetuta jugosllave e vitit 1974, nuk duhet të thirremi vetëm në shkronjat e Kushtetutës, por edhe në shpirtin e saj. E atëherë janë konsekuencat të qarta, ashtu siç është e qartë edhe ajo, që Kosova si krahinë autonome në federatën jugosllave nuk mund të krahasohet me asnjë autonomi ekzistuese, ose ish autonomi në cilin do shtet të ndërlikuar, të tashëm ose të dikurshëm. Kroacia është udhëhequr pikërisht nga kjo, kur e ka vendosur, të pranojë Kosovën të pavarur. Kemi menduar, se nuk ka rrugë tjetër. Bisedat mbi statusin e Kosovës nuk kanë dhënë kurrfarë rezultati, në federatë pjesë përbërëse e së cilës, d.m.th: si pjesë konstituive Kosova ka qenë. Edhe pse ka qenë e lidhur me Republikën e Serbisë, kjo federatë nuk ka ekzistuar më dhe është dashur të përcaktohet se çka do të bëhet me Kosovën. Administrimi ndërkombëtar në kohë të pacaktuar, po ashtu nuk ka qenë kurrfarë zgjidhje. Është e qartë, se Serbia vështirë të pajtohet me atë që ka humbur, pjesë e cila ka qenë gati njëqind vjet të fundit në përbërjen e saj, por edhe pjesa e cila është e pandarë dhe e lidhur me rrënjët e saja



historike. Është e qartë se Serbia e ka të vështirë ta sjelli vendimin për pranimin e Kosovës. Shumë herë e kam thënë e do ta përsëris edhe sot: Serbia nuk do ta pranojë Kosovën, por kurdo herë nëse për asgjë tjetër, atëherë për shkak të interesave të serbëve që jetojnë këtu, duhet të vendos një modus vivendi të caktuar për Kosovën. Është mirë që qytetarëve të nacionalitetit serb të mos u këshillohet më që të refuzojnë bashkëpunimin dhe pjesëmarrje në organet e pushtetit të shtetit të ri, që të bojkotojnë zgjedhjet dhe kështu vetvetes t'i pamundësojmë të drejtën e vendosjes mbi atë se si do të jetojnë. Është mirë që të pushojnë së ushqyeri ëndrrat jo reale mbi atë se ende nuk ka përfunduar, se rrota historike mund të kthehet mbrapa. Nuk mundet! Është shkatërruar ish federata e Jugosllavisë, të gjithë e dinë, tërë bota e di, kush e mban përgjegjësinë më të madhe për këtë shkatërrim dhe me këtë shkatërrim ka qenë vetëm pyetja e kohës, kur do të vijë pavarësia e Kosovës. As që mund të kthehet federate jugosllave, e as Kosova nuk mund të kthehet në gjendje në të cilën ka qenë para shpalljes së pavarësisë. Arkitektura e kësaj hapësirë është kryer dhe tani është para të gjithëve. Theksoj: para të gjithëve, detyra e madhe e hyrjes në Evropë të bashkuar.

## Do hyjmë në Evropë me rregulla të njëjta ligjore, me kufij të hapur, me liri të plotë të lëvizjes së njerëzve.

Kjo Evropë e bashkuar do t'i bëjë problemet, që sot duken si të pazgjidhshëm, thjeshtë qesharake. Me rregulla të njëjta ligjore, me kufij të hapur, me liri të plotë të lëvizjes së njerëzve, duke përfshirë këtu edhe fuqinë punëtore, mallrave dhe kapitalit. Kush do të lodhet me mosmarrëveshjet rreth asaj, çka dhe kur i ka takuar dikur dhe çka, në bazë të këtyre të drejtave historike, ndoshta edhe sot duhet dikujt t'i takojë.

Kroacia nuk humb nga pamja rëndësinë e marrëdhënieve të veta me fqinjën tuaj të veriut dhe është maksimalisht e interesuar për ngritjen e këtyre marrëdhënieve në nivel më të lartë. Por, ne nuk mund të lejojmë që marrëdhëniet tona, me cilin do vend në rajon, të bëhen peng i marrëdhënieve me ndonjë vend tjetër të rajoni të njëjtë, respektivisht që cili do vend të "ushtrojë ashpërsinë" për arsye se kemi bërë veprim të logjikshëm, veprimin të vetëm të mundshëm, që kemi pranuar Kosovën e pavarur dhe se me një Kosovë të tillë dëshirojmë të bashkëpunojmë.

Jetojmë në kohën në të cilën vetëvendosja e popullit, të drejtat e njeriut, demokracia, paqja, zhvillimi, siguria, mbrojtja e ambientit, janë ligjet kryesore, ose së paku duhet të jenë. Prej kësaj, në të vërtetë, varet se çfarë do të jetë e ardhmja jonë. Prej kësaj dhe asgjë tjetër, varet se a do të mbesim të robëruar në prangat e mosmarrëveshjeve të cilat e kanë shënuar shekullin e 20-të, ose do të gjejmë fuqi të bëjmë hapin përpara në këtë shekull të ri, në këtë milenium të ri, në kohën kur raca njerëzore më në fund duhet të tregojë pjekuri të nevojshme që t'i përkushtohet çështjeve prej të cilave varet ekzistenca e saj në të ardhmen.

Rrethi ynë i afërt është Evropa Juglindore, rajon në të cilin shumicën e vendeve e përbëjnë shtete të dala nga ish Jugosllavia. Disa prej tyre kanë qenë të kapluar drejtpërsëdrejti, ose jo drejtpërsëdrejti, me luftëra në të cilat është shkatërruar Jugosllavia, sikurse Kroacia, Bosnja dhe Hercegovina, Serbia dhe Mali i Zi, disa ia kanë dalë t'i ikin shkatërrimeve luftarake, si Maqedonia, disa rrugën e vet të rëndë e kanë përjetuar, kur luftërat shpërbërës kanë përfunduar, si Kosova.

Ne të gjithë mbajmë shenjat e dhjetëvjetorit të fundit të shekullit të njëzetë dhe të gjithë luftojmë me këtë që të pranojmë të vërtetën mbi atë çka ka ndodhur, veçanërisht mbi rolin tonë në këto ngjarje. Por, këtë të vërtetë duhet ta pranojmë, të vërtetën mbi veten tonë dhe të tjerëve. E vërteta na drejton deri te individualizimi i fajit për krimet e luftës, atje ku janë kryer, ndërsa individualizimi i fajit, e largon fajin nga populli, me fjalë të tjera e largon fajin kolektiv.

Kështu dhe vetëm kështu mund të ndërtojmë të ardhmen në bashkësi. Natyrisht, nuk flas për ndonjë shtet të ri të përbashkët. Kjo kohë ka kaluar. Flas vetëm për nevojën e bashkëpunimit të shteteve të pavarura dhe zgjidhjes së përbashkët të problemeve, si dhe paraqitjes së përbashkët ndaj vendeve të treta dhe në tregjet e vendeve të treta.

Republika e Kroacisë, në krye të së cilës pata nder të jem për një dekadë të tërë në këtë periudhë, vazhdimisht është përpjekur për bashkëpunim rajonal. Është angazhuar për lirim nga ngarkesa e së kaluarës dhe kundër korigjimit të historisë, duke përfshirë këtu edhe djallëzinë e antifashizimit. Por, mbi të gjitha është angazhuar për dialog të barabartë dhe me të drejta të njëjta, për përtëritjen e besimit të ndërsjellë dhe mirëkuptimit.

Kjo është konstantja e politikës, që e kam përfaqësuar dhe udhëhequr. Kroacia në dekadën e kaluar i ka ofruar dorën e bashkëpunimit të gjithë fqinjëve dhe të gjithë vendeve të rajonit. Me shumicën prej tyre kemi nënshkruar edhe deklaratat mbi parimet në të cilët do të mbështeten marrëdhëniet të ndërsjella, ashtu si dhe në çdo marrëdhënie tjetër. Që të jetë e suksesshme, duhet të kemi partner. Disa partnerët tanë i kanë arsyetuar pritjet, disa nuk i kanë plotësuar pritjet tona, aq sa kemi pritur, respektivisht sa kemi shpresuar, e disa kanë dështuar. Do të kuptoni pse nuk emëroj vendet për të cilat po flas.

Ne, nuk mund të ndërtojmë të nesërmen tonë, të ngarkuar me atë çka ka qenë dje, por nuk mund as të lejojmë, që pa skrupull të shtrembërojmë atë çka ka qenë e vërtetë. Unë zakonisht e them, se ka ndodhur vetëm ajo çka ka ndodhur. Vetëm atë dhe asgjë më shumë. Të pranojmë atë çka ka ndodhur, të nxjerrim mësim nga ajo dhe t'i kthehemi së ardhmes.

Në shërbim të kësaj të ardhme unë jam sot këtu në Prishtinë, kryeqytetin e Kosovës.

Këtu jam, që të ftoj në ndërtimin e marrëdhënieve sa më të mira dhe sa më të zhvilluara ndërmjet Kroacisë dhe Kosovës, por edhe në përtëritjen, kisha me thënë: ringjalljen e bashkëpunimit rajonal në shërbim të forcimit të stabilitetit në rajon dhe në shërbim të përgatitjes të të gjitha vendeve të rajonit për hyrje në Evropë të bashkuar, respektivisht në integritet Euro-atlantike.

Interesi ynë i vërtetë është, që në Evropë të hyjmë të bashkuar, që në Bashkimin Evropian, të gjenden të gjitha vendet e rajonit dhe ne jemi të gatshëm, që çdonjërit prej këtyre vendeve t'i ndihmojmë që sa më shpejt të kalojë rrugën, së cilës ne jemi duke shkuar. Kjo vlen edhe për Republikën e Kosovës, sado që ajo tani ndoshta duket larg.



## Demokracia është shumë më shumë se kjo.

Dhe, në fund, nja dy tri fjalë për botën në të cilën jetojmë. Nuk mund t'i iki kësaj, sepse bota e globalizuar është me të vërtetë gjithnjë më e vogël dhe nuk ka vend i cili mund t'i iki varësisë dhe ndërlidhjes që e karakterizon.

Jemi dëshmitarë të simptomave të qarta të thyerjes të modelit neoliberal, i cili është shprehur në krizën ekonomike që na ka goditur të gjithëve, pa marrë parasysh, se a i kemi shtuar edhe diçka "nga kuzhina jonë". Për fat të keq, më duket se ende nuk ekziston gatishmëria që të fillohet seriozisht, të mendohet mbi atë çka tash për tash thjeshtë quhet rendi i ri botëror. Është koha e fundit për këtë.

Jetojmë në botën, e ardhmja e së cilës është seriozisht e rrezikuar me ndotjen e ambientit dhe ngrohjes globale. Nuk është frazë, nëse thuhet se është në pyetje ekzistenca e racës njerëzore. Por, përsëri më duhet të përsërisë shprehjen : për fat të keq, konferenca e paradokohshme mbi ndryshimet globale klimaterike, ka treguar se si interesat e ngushta nacionale ende dominojnë mbi ato të përgjithshmet, i vetmi interes i përgjithshëm, është ruajtja e jetës në Tokë.

Jetojmë, së fundi, në botën në të cilën demokracia është në rrugë që globalisht të fitojë. Duke ju tërhequr vërejtjen se, natyrisht, ekzistojnë vlerat universale, të pranuar në përgjithësi, por nuk guxon të ekzistojë një model i uniformuar, të cilin në emër të çfarëdo ideali, ose interesi guxon t'i imponohet të tjerëve. E kjo ekziston, ose : së paku ka pasur dhe nuk guxon të përsëritet.

Për ne në rajon, e me këtë do të përfundojë, ndërtimi i demokracisë është i pandarë, i lidhur me nevojën për luftë të ashpër, pa kompromis kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar. Në shtetet tona demokracia shtetërore, shikuar objektivisht, ende është në foshnjëri. Nuk duhet të lejojmë që, me çfarëdo arsytimi, të krijohet demokraci e trilluar, që demokracia të vlerësohet vetëm dhe vetëm sipas numrit të zgjedhjeve të mbajtura.

Demokracia është shumë më shumë se kjo.

Askush në rajon, askush në botë nuk guxon këtë ta harroj. E tek ne është, që në kornizat tona të vogla rajonale, të tregojmë dhe vërtetojmë që ne këtë nuk e kemi harruar. Me këtë do të legjitimohemi më së miri si qytetarë të botës, me këtë do të vërtetojmë më së miri që mund të kontribuojmë se bota nesër të jetë më e mirë se sa kjo e sotme.

Delegacioni i Kuvendit të Kosovës, i kryesuar nga kryekuvendari , dr. Jakup Krasniqi, mori pjesë në punimet e Konferencës Ndërkombëtare Parlamentare në Londër dhe Belfast

# Pavarësia ka krijuar kushte të favorshme për investime të kapitalit të huaj në Kosovë

Pritje shumë e ngrohtë dhe miqësore te kryetari i Dhomës së Përfaqësuesve të Parlamentit të Mbretërisë së Bashkuar, zoti John Bercow

Takimet u shfrytëzuan edhe për të sensibilizuar, sidomos vendet që ende nuk e kanë njohur Republikën e Kosovës, për ta bërë atë

Kushtetuta e re e Kosovës së pavarur përfshin të gjitha provizionet e Pakos së Ahtisaarit, të mbështetura ndërkombëtarisht

Zoti Krasniqi e ftoi kryetarin Bercow ta vizitojë zyrtarisht Republikën e Kosovës



*Takimi Krasniqi- John Bercow*

Me ftesë të Asociacionit Parlamentar të Komonveltit Britanik, delegacioni i Kuvendit të Kosovës, i kryesuar nga kryetari i Kuvendit , dr. Jakup Krasniqi, në përbërje të të cilit ishin edhe anëtar i Kryesisë, Ibrahim Gashi, shefi i Kabinetit të kryetarit , Mehmet Hajrizi dhe këshilltari për marrëdhënie me jashtë, Skënder Reçica, mori pjesë në punimet e Konferencës Ndërkombëtare Parlamentare mbi Ndërtimin e Paqes, e cila u mbajt në Londër dhe Belfast.) Në Konferencë, e cila trajtoi aspekte të ndryshme paqëndrues në vendet e dala nga konflikti po marrin pjesë përfaqësues të 40 vendeve nga bota.

Qëllimi i kësaj Konference është forcimi i rolit të parlamentarëve në promovimin e paqes së qëndrueshme, sigurisë dhe zhvillimit.

*Në Kosovë ka siguri, klimë politike stabile, frymë pajtuese dhe bashkëpunimi ndëretnik*

Delegacioni i shoqëruar edhe nga ambasadori i Kosovës në Mbretërinë e Bashkuar, Muhamet Hamiti, pati një pritje shumë të ngrohtë dhe miqësore te kryetari i Dhomës së Përfaqësuesve të Parlamentit të Mbretërisë së Bashkuar, zoti John Bercow.

Bercow është kryetari i 167-të me radhë i Dhomës së Përfaqësuesve të Mbretërisë së Bashkuar, i zgjedhur në qershor 2009. Ai është anëtar i Parlamentit nga radhët e konservatorëve që nga viti 1997. Në takim kryetari Krasniqi falënderoi për mikpritjen dhe për mbështetjen që Mbretëria e Bashkuar i ka dhënë Kosovës në të gjitha planet. Në mënyrë të veçantë ai theksoi përkrahjen e argumentuar që Mbretëria e Bashkuar i ka bërë pavarësisë



gjitha provizionet e Pakos së Ahtisaarit, të mbështetura ndërkombëtarisht.

Zoti Krasniqi kërkoi nga Mbretëria e Bashkuar të vazhdojë mbështetjen e Kosovës në synimin e saj të anëtarësimit në OKB dhe në organizmat e tjerë ndërkombëtarë.

Mbretëria e Bashkuar, vazhdoi Krasniqi, është vend i madh dhe me kredibilitet të lartë ndërkombëtar, prandaj presim që do të vazhdojë të ndikojë të miqtë e saj të shumtë për njohjen sa më të shpejtë dhe më të gjerë të Republikës së Kosovës, për t' i bërë të mundur kështu hyrjen e saj në familjen e madhe të Kombeve të Bashkuara.

Kryetari Krasniqi e njoftoi homologun e tij për zgjedhjet e suksesshme vendore, të organizuara nga institucionet e Kosovës. Një nga prioritetet e larta të institucioneve të Kosovës, theksoi ai, është integrimi i qytetarëve serbë në të gjitha fushat e jetës në Kosovë. Për këtë qëllim ne kemi përbushur obligimet legjislatve që dalin nga Pakoja e presidentit Ahtisaari, kurse me zgjedhjet e reja bëmë

themelimin dhe funksionalizimin e komunave të reja me shumicë të komunitetit serb. Lidhur me problemet në Veri të Kosovës, zoti Krasniqi kërkoi mbështetje ndërkombëtare për Strategjinë e përbashkët të ICO-së dhe Qeverisë për integrimin e plotë të komunitetit serb dhe të vendosjes së rendit kushtetues në atë pjesë të vendit tonë. Kryetari Krasniqi foli edhe për procesin e integritimit evropian, për zbatimin e rekomandimeve të Raportit të Progresit të Komisionit Evropian dhe për përparimin e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë.

Pavarësia, vazhdoi ai, ka krijuar dhe po krijon kushte të favorshme për investime të kapitalit të huaj në Kosovë, siç janë siguria e stabiliteti politik, infrastruktura ligjore e fizike, telekomunikimet dhe lehtësitë doganore e tatimore, sigurimi i një mjedisi të qëndrueshëm biznesi, të cilat bashkë me pasuritë e mëdha dhe potencialin rinor e fuqinë e lirë punëtore, do të tërheqin investime të huaja dhe do të mundësojnë zhvillim të shpejtë.

Duke e njoftuar me punën e Kuvendit dhe të arriturat e tij, zoti Krasniqi shprehu bindjen se

do të vazhdojë ndihma e parlamentit britanik dhe do të thellohen marrëdhëniet ndërmjet dy parlamenteve. Ai theksoi sidomos nevojën që ka Kuvendi i Kosovës për bashkëpunim dhe asocim rajonal dhe ndërkombëtar. Kjo do të ishte në të mirë të paqes e stabilitetit në rajon dhe do të ndihmonte Kosovën për integrim më të shpejtë evropian.

Zoti Krasniqi e ftoi kryetarin Bercoëta vizitë zyrtarisht Republikën e Kosovës. Kryetari Bercoë, pasi e pranoi me kënaqësi ftesën, tha se është shumë i interesuar ta vizitojë Kosovën. Ai foli me admirim për pavarësinë e Kosovës dhe për të arriturat e vendit tonë, si dhe për funksionalitetin e institucioneve. "Lidhjet midis dy parlamenteve tona janë shumë të mira, por duhet t' i përparojmë më tej. Ne e kuptojmë nevojën tuaj që Republika e Kosovës të njihet sa më gjerësisht në botë, si dhe nevojën që Kuvendi të anëtarësohet në Unionin Ndërparlamentar", theksoi ai. Delegacioni vazhdon pjesëmarrjen në punimet e Konferencës dhe pritet të takohet

pjesëmarrës të vendeve të ndryshme, por edhe me personalitete, si Lordi Roberston etj. Këto takime u shfrytëzuan edhe për të sensibilizuar, sidomos vendet që ende nuk e kanë njohur Republikën e Kosovës, për ta bërë atë.

Zoti Krasniqi i shoqëruar nga ambasadori i Kosovës në Londër, z. Muhamet Hamiti, takoi edhe drejtorin për Ballkanin në Ministrinë e Jashtme të Mbretërisë së Bashkuar, Daniell Cearn. Në Asamblesë të Irlandës së Veriut, kryekuvendari Krasniqi u prit nga kryetari i Asamblesë, zoti Wiliam Hay. Kryetarin Hay, z. Krasniqi e njoftoi me zhvillimet në Kosovë, me rezultatet e arritura pas shpalljes së pavarësisë dhe me punën e Kuvendit të Kosovës. "Ne po takohemi me udhëheqjet e parlamenteve të vendeve të ndryshme me qëllim të vendosjes së marrëdhënieve të rregullta dhe shkëmbimit të përvojave", theksoi z. Krasniqi. Në këtë funksion zoti Krasniqi e ftoi mikpritësin për një vizitë zyrtare në Republikën e Kosovës dhe në



#### **Takimi Krasniqi- Wiliam Hay**

edhe me kryetarin e Parlamentit të Irlandës së Veriut, zotin William Hay.

#### **Kryekuvendari Krasniqi u prit edhe nga kryetari i Asamblesë së Irlandës, zoti Wiliam Hay**

Delegacioni i Kuvendit të Kosovës, i kryesuar nga kryekuvendari, dr. Jakup Krasniqi, mori pjesë edhe në punimet në vazhdim të kësaj Konferënce në Belfast të Irlandës Veriore.

Gjatë punimeve të Konferencës kryetari Krasniqi bashkë me anëtarët e delegacionit pati takime të shumta me përfaqësues –

Kuvendin e saj. Zoti Hay bëri një paraqitje të punës së Asamblesë që ai drejton, të vështirësive nëpër të cilat ka kaluar Irlanda e Veriut dhe të rezultateve të shënuara politike që ka arritur viteve të fundit.

Ai shprehu kënaqësinë për të arriturat e Kosovës dhe gatishmërinë që bashkëpunimi ndërmjet dy parlamenteve të thellohet edhe më. "Ne dëshirojmë t'ju ndihmojmë në të gjitha fushat ku keni nevojë dhe ku mundemi", theksoi zoti Hay. Takimi kaloi në një frymë miqësie dhe bashkëpunimi.

Konferenca i mbylli punimet me një marrëveshje të përbashkët të pjesëmarrësve.

# Drejtësia me një riorganizim dhe mendim të ri

## *Si është situata juridike në Kosovë?*

Kosova është në hapat e para dhe natyrisht ka shumë për të bërë, ka shumë për të përmirësuar në drejtim të respektimit të të drejtave të njeriut, pavarësisë së institucioneve dhe fenomeneve negative të korrupsionit ekonomik e politik.

Demokracia, të drejtat e njeriut dhe konstitucionalizmi janë koncepte dinamike dhe vazhdimisht në zhvillim. Ndaj për të ndërtuar institucionet e drejtësisë në një nivel sa më të lartë, duhet të forcojmë parimet, dhe të ndërtojmë standardet dhe vlerat e botës ku dëshirojmë të integrohemi.

Kjo duhet të jetë sfida jonë e përditshme e të gjithëve, deputetëve, juristëve, gjyqtarëve prokurorëve, institucioneve në tërësi, shoqatave dhe qytetarëve të Kosovës.

Ne kemi arritur një pikë deri tani, siç është ndërtimi i institucionit të Avokatit të Popullit. E natyrisht, ushtrimi në mënyrë të efektshme i përgjegjësive në mbrojtje të të drejtave të njeriut, lidhet domosdoshmërisht me një qeverisje të kontrollueshme, një parlament pluralist dhe një gjyqësor të pavarur.

Qeveria e Kosovës është e re dhe akoma nuk ka një pavarësi të plotë, e kjo ka sjellë edhe kontradikta në ndërtimin institucional.

Kuptohet që gjyqësori dhe prokuroria kanë probleme të mëdha. Problemet e trashëgimisë, të psikologjisë, kontradiktave ligjore, të cilat shpesh përplasen me njëra tjetrën, shpesh edhe me korrupsionin e gjyqtarëve të ndryshëm. Kemi shumë raste të përgojimit të gjyqtarëve për korrupsion, një pjesë e të cilëve janë në proces, si edhe një pjesë të cilët janë denoncuar, për pezulli nga këto institucione etj.

Vendim marrja është një problem tjetër shumë i madh për gjyqësorin. Akoma institucionet tona nuk kanë pavarësi të plotë në vendim marrje. Prania e institucioneve ndërkombëtare në vendimarrje ka sjellë shpesh kontradikta në punën e këtyre institucioneve. Po punohet shumë në ndërtimin e disa institucioneve të pavarura që pothuajse nuk i kemi fare.

Shoqëritë moderne, po provojnë çdo ditë e më shumë se egzistenca e këtyre institucioneve sipas ndarjes klasike të tre pushteteve është e paplotë, pa veprimtarinë e institucioneve të tjera të pavarura, të cilat së bashku bëjnë që të mirë funksionojë sistemi i kontrollit dhe balancës së pushteteve, dhe luajnë një rol të rëndësishëm në një shoqëri civile. Pra është një skenë, e cila s'ka vlerë pa aktorët e saj në lojë. Domethënë: kemi Kuvendin, si institucion legjislativ, Avokatin e popullit si institucion kontrollues të pavarur, dhe gjykata e prokurori të varura, plus institucione të tjera ndihmëse në fushën e drejtësisë të pa ndërtuara.

## *Në agjenden e vitit 2010 Ka projektligje projektligje të reja që ndihmojnë në riorganizimin e këtyre institucioneve.*

Në strategjinë e saj të re, Qeveria ka planifikuar një numër të konsiderueshëm ligjesh në drejtim të drejtësisë. Kuvendi duhet ti shpejtojë proqedurat, për ti kthyer në ligje. Mund të përmend disa nga projektligjet më kryesore.

- Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Procedurën e Përmbarrimit
- Projektligji për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet penale dhe civile
- Projektligji për ekstradim
- Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Penal
- Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të Procedurës Penale
- Projektligji i drejtësisë për të Mitur
- Projektligji për Avokatin e Popullit
- Projektligji për Gjykatat
- Projektligji për Prokuroritë Publike



## *Me paketën e re, a do të ketë ndryshime të mëdha?*

Në rrugën e integritit të Kosovës në Bashkësinë Evropiane dhe atë Ndërkombëtare, kërkohen shumë reforma dhe reformat më të rëndësishme janë ato që kanë të bëjnë me sistemin e drejtësisë, me shtetin e së drejtës. Kështu që, ne na imponohet të jemi të gjithë bashkëpunues në një frymë kohezioni për të realizuar implementimin e politikave për qeverisjen e gjyqësorit, për kontrollin e gjyqësorit, për vendosjen jo thjesht nga pikëpamja e performancës formale, por për të trajtuar çështje shumë të rëndësishme substanciale që kanë të bëjnë me profilin e gjyqtarit, me karakterin e tyre, me profesionalizmin e tyre për të bërë të mundur që edhe në Kosovë të jepet e drejta si në çdo shtet të Bashkimit Evropian apo dhe më gjerë.

Sot Kosova është përpara momenteve të rëndësishme të jetës së saj. Le të përpiqemi të gjithë të përqafojmë një sens të ri përgjegjshmërie. Le t'u drejtohem vlerave më të mira tona, le të përpiqemi të gjithë ta bëjmë demokracinë në Kosovë një demokraci reale, sipas parimeve dhe standardeve drejt të cilave tashmë jemi nisur.

Paketa e re e ligjeve të ardhura nga qeveria dhe kthimi i tyre në ligje në Kuvend, do ti japë prioritet një riorganizimi të ri të gjykatave dhe prokurorisë. Dhe ky riorganizim do të shfaqet në të gjitha drejtimet.

## **Mendoni në riorganizimin institucional të sistemit të drejtësisë.**

Po, në ndërtimin e institucioneve që mungojnë, p.sh. Me kthimin në ligji të paketës së projektligjeve të reja të ardhura në Kuvend parashihet të ndërtohet Gjykata Administrative.

Është një nga institucionet kryesore që i jep impakt të madh zhvillimit ekonomik të vendit. Dhe Gjykata Administrative do të duhet të realizohet në një kohë sa më të shpejtë, për t'i ardhur në ndihmë dhe përsosur pikërisht sistemin e drejtësisë në Kosovë.

Po kështu Gjykata e Krimeve të Rënda për të cilën Kosova ka shumë nevojë. Situata ndërkombëtare, pjesë e së cilës është edhe Kosova, përvoja e tyre, po e tregon çdo ditë rëndësinë e saj.

Ne sapo kemi ndërtuar shërbimin e Inteligjencës dhe duhet ti kushtojmë një rëndësi të veçantë jo vetëm miratimit të një kuadri ligjor bashkëkohor, por edhe institucionalizimit të bashkëpunimit me agjencitë e specializuara të huaja.

Në mbarë botën, terrorizmi po përbën një kërcënim serioz ndaj sigurisë së brendshme dhe të jashtme të vendeve të veçanta, si dhe ndaj marrëdhënieve paqësore midis shteteve, ndaj zhvillimit dhe

dhe do të kthejnë besimin e qytetarëve tek organet e drejtësisë.

Pikërisht këtu ka lindur edhe konflikti në institucionet tona të prokurorisë dhe gjykatave. Një numër i madh juristësh të vjetër, të cilët kanë punuar në sistemin e vjetër, shpesh nuk u përshtaten ligjeve të reja, krijojnë konfuzion, nuk kanë besim tek juristët e rinj, i zvarritin proceset, nuk kanë etikën e duhur të ligjvënsit etj, etj. Të gjitha këto kanë krijuar mpakte jo pozitive, ndaj po bëhet një punë e mire kualifikuese dhe trajnuese në këtë drejtim.

Natyrisht këtu kemi kontributin dhe ndihmën e madhe të institucioneve ndërkombëtare.

Kemi arritur në trajnimin e një grupi juristësh të rinj. Gjithashtu kemi një grup juristësh të rinj, që kanë përfunduar në shkollat e perëndimit dhe shumë shpejt do të inkuadrohen në organet e Gjykatave dhe të Prokurorisë.

Numri i juristëve është i vogël dhe shpesh ka qënë e pamundur përfundimi i shumë proceseve penale apo civile.

Po marr një shembull. Në Kosovë për të miturit ka vetëm një gjyqtar që mbulon këtë fushë për Prishtinën, Lipjanin, Gjilanin dhe mendo volumin e madh që duhet të mbulojë ky gjyqtar, plus, shpesh edhe



funkcionimit të institucioneve dhe parimeve demokratike.

Ne duhet tu bashkohemi të gjitha përpjekjeve e luftës të vendeve demokratike duke u bërë pjesë edhe e strategjive dhe veprimeve parandaluese ndaj atyre që sponsorizojnë, organizojnë ose kryejnë akte terroriste.

Ndaj Gjykata e Krimeve të rënda duhet të projektohet në infrastrukturën e saj të plotë, pasi infrastruktura ligjore është heterogjene dhe ka sjellë një çoroditje në drejtësi. Prokuroria dhe Gjykatat nuk kanë funksionuar si organe vendore. Aktualisht EULEX merr pjesë të drejtpërdrejtë në proceset vendimmarrëse ligjore.

Në paketën e projektligjeve të reja të propozuara nga qeveria, do të përmirësohen dukshëm Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale, pasi në atë ekzistues ka mangësi të ligjeve

Këto dhe të tjerat janë objektiva në projektet tona të së ardhmes. Me siguri ndërtimi i këtyre institucioneve do të japin impaktet e veta për shoqërinë tonë, do ti japin një impuls akoma më të madh dhe me siguri do të ndryshojnë sistemin e Drejtësisë do të ndërtojnë një psikologji të re në punën juridike.

**Po në shtimin e numrit të gjyqtarëve dhe plotësimin me juristë të rinj.**

Duke futur gjak të ri do të ndryshojmë edhe opinionin e keq të krijuar

pengesat e tjera të pajustificueshme dhe del përfundimi i efektshmërisë juridike. Ndaj mendoj se me aprovimin e këtyre ligjeve, ristrukturimi i gjykatave dhe prokurive do të ndryshojë shumë gjëra.

## ***Cili është bashkëpunimi juaj me institucionet ndërkombëtare në fushën e drejtësisë?***

Në këtë proces integrimi do të falënderoja në mënyrë të veçantë për kontributin e vazhdueshëm të të gjithë ekspertëve ndërkombëtarë, të cilët kanë qënë mjaft profesionistë, mjaft bashkëpunues gjatë gjithë kësaj periudhe kalimtare dhe do të vazhdojnë ta japin akoma këtë kontribut. Ata janë dëshmitarë të ndryshimeve të mëdha, që po ndodhin në Kosovë e natyrisht në drejtësi.

Nga ana tjetër, ja vlen ta përmend se janë mjaft të kujdesshëm për t'i dhënë mbështetje procesit të riorganizimit dhe përmirësimit të punës në sistemin gjyqësor; gjithashtu, kanë qënë mbështetje shumë e rëndësishme për t'u dhënë kurajë gjyqtarëve, sistemit gjyqësor, në mënyrë që ky sistem, gradualisht, të fitojë autonominë mbi bazën e asaj që ia jep Kushtetuta dhe ligji, që ky pushtet të ndërtojë individualitetin e vet dhe të jetë i pavarur nga politika, dhe nga të gjitha varësitë e tipit korruptim.

***Bisedoi: Petrit Subashi***

# Gazetarët flasin për Kuvendin

Gazetarët, të cilët e përcjellin punën e Kuvendit të Republikës së Kosovës, vlerësojnë pozitivisht punën e Kuvendit. Ata thonë se kanë bashkëpunim korrekt me drejtuesit e Kuvendit, deputetët dhe me stafin brenda Kuvendit, ndërsa nuk mungojnë as kërkesat e tyre që Kuvendi t'iu ofrojë kushte më të mira të punës në këtë institucion.

Duke e përshëndetur transparencën që mbizotëron në Kuvend, ata njëherazi theksojnë se gjatë vitit 2009 Kuvendi i Republikës së Kosovës, ka përmbytur në masë të madhe punën e tij dhe ka miratuar një numër mjaft të madh të ligjeve

**Enver Bajrami, gazetar në Radio Televizionin e Kosovës (RTK),** punën e Kuvendit e vlerëson në mënyrë pozitive.

“Kuvendi i Kosovës ka arritur që në masë të madhe të kryej punët dhe obligimet që ka. Do t'i jepja një vlerësim pozitiv punës së Kuvendit, megjithëse shqetësuese për mua mbetet gjuha që herë pas herë përdoret nga deputetët në seancat e Kuvendit”, thotë fillimisht Bajrami. Bashkëpunimin Kuvend i Kosovës-gazetarë, ai e vlerëson si korrekt. “Mendoj se ekziston një bashkëpunim korrekt, edhe pse jo gjithëherë nevojat e gazetarëve mund të plotësohen”, shprehet Bajrami, duke shtuar se kushtet e gazetarëve që raportojnë nga Kuvendi janë solide. Megjithatë, sipas tij, gjithmonë ekziston mundësia që këto kushte të përmirësohen. Ai mendon se duhet të ketë përmirësim të kushteve për gazetarët që raportojnë nga Kuvendi, si dhe të ketë një trajtim më dinjitoz të tyre nga ana e personelit të Kuvendit.

Kuvendin e Kosovës, Bajrami e vlerëson si një institucion përgjithësisht transparent. “Fakti që seancat e Kuvendit transmetohen drejtpërdrejt, e bëjnë Kuvendin një prej institucioneve me transparente në Kosovë. Megjithatë, një dozë e jo transparencës ekziston kur bëhet fjalë për mbledhjet e komisioneve parlamentare dhe zhvillimeve të tjera, me të cilat merret Kuvendi”, thotë ai.

Gazetari i RTK-së, Enver Bajrami, sugjeron që Kuvendi t'a përmbytur agjendën legjislativë, si dhe të ketë një kontroll më të madh ndaj punës dhe veprimeve të qeverisë, por edhe të institucioneve tjera, të cilat i ka zgjedhur.

**Gazetari, Agron Halitaj, nga gazeta e përditshme 'Koha ditore',** pohon se Kuvendi i Kosovës nuk ka arritur të punoj me dinamikë të njëjtë gjatë tërë vitit. “Derisa në sesionin pranveror është vërejtur një angazhim më i madh i deputetëve si në punën e komisioneve parlamentare, ashtu gjatë seancave plenare, në sesionin vjeshtor, trendi i punës ka degraduar në masë të dukshme. Shumë mbledhje të komisioneve kanë dështuar, e po ashtu edhe disa seanca plenare janë ndërprerë në mungesë kuorumi, për shkak të pjesëmarrjes së deputetëve në fushatë për zgjedhjet lokale.

Në degradimin e punës së Kuvendit ka ndikuar edhe rasti Bllaca, pasi në Kuvend u krijua një atmosferë tensionuese mes grupeve parlamentare”, thekson Halitaj. “Është fakt i përsëritshëm që Kuvendi edhe sivjet nuk ka arritur të ushtroj kontrollin e duhur mbi organet të cilat i ka themeluar vet, përfshirë Qeverinë”, thotë Halitaj. Në anën tjetër, opozita, thotë më pas ai, nuk ka dëshmuar ndonjë kreativitet gjatë punës në kuvend, për faktin se shumë rrallë ka ngritur çështje për debat parlamentar, e shumë më pak ka kërkuar interpelancë të anëtarëve të kabinetit qeveritar.

Sa i përket bashkëpunimit Kuvend i Kosovës-gazetarë, Halitaj thotë se gjatë përcjelljes së punës së Kuvendit, ka arritur të vë ura të mira bashkëpunimi me të dyja nivelet: me përfaqësuesit politik të zgjedhur të popullit si dhe me personelin e administratës së Kuvendit.

Gazetarët, shton ai, si çdo kategori tjetër e shoqërisë, gjithmonë janë në kërkim të kushteve më të mira për punë. “Aktualisht,

kushtet e punës së gazetarëve në Kuvend, nuk janë ato të dëshiruarat”, thekson Halitaj, duke shtuar se kanë hapësirë të ngushtë në Kuvend, televizori ndonjëherë nuk punon, e kompjuteri nuk ka qasje në internet. “Jam i prirë të besoj se këto kushte do të ndryshojnë, pas rregullimit të paralajmëruar të hapësirës mbi sallën ku mbahen seancat plenare”, vlerëson Halitaj.

Megjithatë, sipas tij, puna e Kuvendit kryesisht është transparente. Kjo për faktin se seancat plenare dhe pjesa dërmuese e mbledhjeve të komisioneve parlamentare janë të hapura për media dhe për mekanizmat monitorues të shoqërisë civile. Ndërsa, për Kryesinë e Kuvendit, thotë se akoma i mbajnë mbledhjet e mbyllura dhe ende vazhdon të mos lejojë që të postohen në ueb faqe transkriptet e mbledhjeve që i zhvillon. “Në fakt, anëtarët e Kryesisë në shumë raste, kur kanë dashur të flasin apo të marrin ndonjë vendim të rëndësishëm janë përkujdesur që t'i shqyrcin mikrofonat për të bërë të pamundur transkriptimin e fjalëve të tyre”, shprehet ai.

Halitaj, këshillon se Kuvendi duhet t'a fuqizojë rolin kushtetues mbi organet, të cilat vetë i ka krijuar, ndërsa mendon se Kuvendi duhet që të angazhojë më tepër ekspertë të lëmive të ndryshme, të cilët do t'i ndihmonin komisionet parlamentare gjatë shqyrtimit të projektligjeve, si dhe ta dinamizonte procesin e monitorimit të zbatueshmërisë së ligjeve në praktikë.

**Zijadin Gashi, nga gazeta “Zëri” dhe Radio “Evropa e Lirë”,** thotë se Kuvendit të Kosovës i mungon një debat i mirëfilltë. “Ai është Kuvend për të kuvenduar. Në



Enver Bajrami, (RTK)



Agron Halitaj, 'Koha ditore'



Zijadin Gashi, “Zëri”, “Evropa e Lirë”

shohim se aty vetëm votohet. Kurse debati dhe diskutimet zhvillohen brenda partive politike. Gjithashtu, unë pajtohem me konstatimet e monitoruesve se debatet më interesante zhvillohen në hollin e Kuvendit dhe konferenca për media të cilat zakonisht zhvillohen paralelisht me seancat plenare”, thotë Gashi

“Duke i bërë një vlerësim politik, shumica në Kuvend, e kanë lënë anash angazhimin e tyre si grupe parlamentare dhe si deputet të zgjedhur të popullit, dhe kontributi i tyre në Kuvend është votimi apo kundërshtimi, dhe jo debati e studimi, apo elaborimi i shumë çështjeve jetike që shtrihen në Parlamentin e këtij vendi”, thotë ndër të tjera gazetari Zijadin Gashi.

Sa i përket bashkëpunimit-gazetarë-Kuvend, Gashi thekson se bashkëpunimi, nënkupton ftesat e gazetarëve në takimet e komisioneve, takime me deputet e deri te ato me Kryetarin e Kuvendit. “Përderisa me komisionet nuk kemi përvoja të mira, pasi që mediat ftohen, por zakonisht nuk lejohen t’i përcjellin takimet e tyre, mund të them se personalisht nuk kam hasur pengesa që të aranzhoj takime me Kryetarin dhe me deputetët, për të cilat kam shprehur interesim t’i takoj”, thotë ai.

Ndërsa, se çfarë kushtesh gëzojnë gazetarët në Kuvendin e Kosovës, ai thotë se kur mbahen seancat plenare, gazetarët shpesh detyrohen të qëndrojnë në pjesën e poshtme të hollit të Kuvendit. “Atyre, madje nuk u lejohet as të porosisin kafe, përderisa deputetët qëndrojnë në të njëjtin holl me një arsyetim që unë nuk e kuptoj”, thotë ai, duke shtuar se edhe hapësira e punës për përcjelljen e seancave është e zhurmshme dhe pamundëson punën e mediave elektronike, TV-të dhe radiot.

Ai shton se Kuvendi i Kosovës është transparent aq sa edhe institucionet e tjera. “Transparenca në Kosovë ende është vetëm në paralele me interesin që kanë institucionet për të publikuar punën e tyre, por jo edhe me çështjet e tjera... Pra, transparenca mbetet në harmoni me atë që e kemi edhe në institucionet e tjera. Në Kosovë, ka transparencë aq sa lejojnë dhe aq sa ju konvenon këtyre institucioneve dhe bartësve të tyre”, thekson

Gashi. Gazetarët, shton ai, tashmë janë pjesë e pashmangshme e asaj që mund të quhet përparim i punës së Parlamentit. “Kurse, në rastet kur pozitë e opozitë heshtin dhe bashkohen rreth interesave të tyre të ngushta, janë gazetarët, ata që bëhen një lloj opozite e vetme, në mënyrë që opinioni të mos mbetet në terr total informativ”, vlerëson ai.

Gazetari i gazetës “Zëri” dhe i Radios Evropa e Lirë, Zijadin Gashi mendon se Kuvendi duhet ta shtoj energjinë dhe dinamikën e punës. “Mendoj se deputeti i mirë, ka për detyrë t’i shërbej atij që e ka sjellë në atë ulëse, popullit dhe jo kryetarit të partisë.

Ky është sugjerimi im kryesor. Kemi deputet që janë aty vetëm sa për të votuar dhe asgjë më shumë”, shprehet Gashi, duke sugjeruar që Kuvendi të formoj një trup mbikqyrës, trup monitorues për zbatimin e ligjeve. “Nëse dëshironi të shmangni kaosin, zbatoni ligjet”, përfundon ai.

**Bekim Kabashi, nga gazeta “Infopress”,** thotë se gjatë vitit 2009 Kuvendi i Republikës së Kosovës, ka përbushur në masë të madhe punën e tij. Ka miratuar një numër mjaft të madh të ligjeve edhe pse në disa raste, sipas tij, ka pasur seanca të dështuara. Sa i përket bashkëpunimit të këtij institucioni me gazetarët, ai shprehet: “Si edhe herave tjera, Kuvendi mbetet një institucion, ku gazetarët nuk e kanë edhe aq të lehtë të kenë çasje. Ndërsa, kushtet për gazetarë nuk janë edhe aq të kënaqshme. Edhe Kabashi ka vërejtje për hapësirën e punës për gazetarë dhe për kushtet e punës që janë aty. Megjithatë, Bekim Kabashi shprehet se Kuvendi si institucion është transparent, meqë shumica e ngjarjeve që zhvillohen në Kuvend u përcjellin mediave. Kabashi, duke kërkuar kushte më të mirë për gazetarët si dhe transparencë dhe një komunikim më të rregullt me mediet, po ashtu këshillon gazetarët që të lexojnë rregulloren dhe ligjet.

**Bajram Lani, nga Agjencia “Kosovapress”,** fillimisht jep kritika pozitive për bashkëpunimin që kanë gazetarët me Zyrën për Informim, në këtë institucion. Ndërkaq, lidhur me punën e Kuvendit ai mendon se diktohet në masë të madhe nga Qeveria. “Në

fakt, janë miratuar pak ligje gjatë vitit që lam pas dhe kjo, sipas zyrtarëve të Kuvendit, ka ndodhë për shkak se Qeveria nuk ka sjellë ligje sa duhet. Megjithatë, edhe Kuvendi duhet të jetë vetë më aktiv në drejtim të hartimit të ligjeve. “Meqë mediat nuk kanë çasje në mbledhjet e Kryesisë dhe brenda në seancat e Kuvendit, nuk ka transparencë të plotë nga ana e legjislativit të vendit”, shprehet ai.

“Duhet të merren masa ndëshkuese për ligjvënësit e padisiplinuar... Duhet të ndëshkohen deputetët që pijnë duhan nëpër holl, mu para shenjave “No smoking”, duhet të ketë më shumë seanca, por të jenë më të shkurtëra”, thotë ai.

Sa i përket kushteve për gazetarët, Lani thekson se nuk janë të favorshme, ndërsa shton se ditëve të ëkëndit, gazetarët nuk lejohet të futën në ndërtesën e Kuvendit, edhe kur kanë ndonjë takim me ndonjë deputet brenda në Kuvend. Lani thotë se ka bashkëpunim të mirë me Zyrën për Informim të Kuvendit, por,

“Gazetarëve duhet t’u krijohen kushte më të mira për punë, duhet të jetë një vend i veçantë për gazetarët, e jo ata t’i ndjekin seancat nëpër korridore dhe të nëpërkëmben nga secili që sillet atypari. Gazetarëve do t’u sugjeroja që të mos i përcjellin seancat e Kuvendit për aq kohë sa nuk ka kushte adekuate”, thotë ai.

**Sahadete Zogaj, gazetare e Agjencisë “Ekonomisti”,** mendon se puna e Kuvendit të Kosovës në përgjithësi është transparente. “Gjatë punës time nuk kam pasur probleme në marrjen e informative që më janë dashur. Staf i informimit në Kuvend më presin shumë mirë, ndërkaq kam çasje edhe në mbledhje të ndryshme, si nëpër komisionet e Kuvendit, përveç në mbledhjet e Kryesisë, që fatkeqësisht akoma zhvillohen me dyer të mbyllura. Megjithatë, kushtet e punës për gazetarë duhet të përmirësohen. Gazetarët janë dritarja, apo ura lidhëse në mes të punës së Kuvendit dhe qytetarëve, prandaj duhet të krijohen kushte të mira të punës edhe për gazetarë”, thotë ndër të tjera Zogaj.

**Luljeta Tahiraj**



Bekim Kabashi, “Infopress”



Bajram Lani, “Kosovapress”



Sahadete Zogaj, “Ekonomisti”

Intervistë me Naim Malokun, anëtar i kryesisë së Kuvendit

# Kufijtë e Kosovës janë të siguruar

Prezenca e KFOR-it, e bënë të sigurt Kosovën në aspektin fizik, por Serbia përpiqet t'ia vështirësojë rrugën e zhvillimit. Rregullorja e re e Kuvendit do të përshpejtojë miratimin e ligjeve

Kuvendi i Republikës së Kosovës, që nga themelimi i tij e deri sot ka pasur rrugën e vet të zhvillimit në kushte dhe rrethana specifike .Për rolin e tij në procesin e shtetformimit, sfidat dhe të arriturat, flet deputeti i Kuvendit të Kosovës Naim Maloku

**Jemi në prag të dyvjetorit të shpalljes së pavarësisë së Kosovës, si do ta vlerësonit punën e Kuvendit gjatë kësaj periudhe?**



Në vitin e parë pas Pavarësisë, kemi pasur punë më intensive sepse është dashur të kalojmë nëpër Kuvend të gjitha ligjet që dalin nga pakoja e Ahtisarit, dhe ligje të tjera që vinin nga Qeveria e Kosovës.

Mendoj se në vitin e kaluar intensiteti i punës ka rënë paksa, nëse merret parasysh numri i miratimit të ligjeve në Kuvend. Kjo është edhe për shkak se Qeveria nuk i është përmbajtur planit legjislativ që ka sjellë në Kryesi të Kuvendit. Janë disa ligje që zvarriten që një kohë të gjatë nëpër komisione, dhe nuk mund të arrijnë në leximin e dytë, qoftë nga ndikimi i jashtëm, (mendoj në faktorët ndërkombëtar dhe qendrat e vendosjes), qoftë nga ndonjë pengesë që del brenda Kuvendit. Me këtë rast do të mirrja dy shembuj:

Ndikimi i faktorit ndërkombëtar mbi Projektligjin për Organizmat Gjenetiksht

të Modifikuar, dhe Ligjin për Rrezatimin Jonizues dhe Jo jonizues, dhe Sigurinë Nukleare (kjo iu ka shtuar më vonë Ligjit).

Për këto dy ligje patëm një sugjerim që, para se të vijmë në leximin e dytë të pritet një vlerësim nga faktori ndërkombëtar, dhe me të drejtë sepse, Kuvendi po ta miratonte ligjin për Organizmat e Modifikuar Gjenetiksht, Kosova nuk ka kapacitete njerëzore e as Tekniko-

vijuar mandatin, nga legjislatura e dytë 66 deputetë. Pra më shumë se gjysma e deputetëve nuk e kanë vazhduar mandatin në legjislaturën e tretë. Për këtë shkak, vazhdimisht në fillimin e legjislaturës, na ka përcjellë një praktikë, me ç'rast është dashur të trajnohet një numër i madh i deputetëve. Në legjislaturën e parë kemi pasur ndihmën e faktorit ndërkombëtar, (UNMIK-ut), dhe të shumë parlamenteve të botës. Kemi hyrë në fazën e trajtimeve dhe kemi pasur mbështetjen që sa më shpejtë të bëhemi të zotët e punës.

Kjo është një specifikë që e ka përcjellë Kuvendin e Kosovës, gjë që nuk ndodhë në praktikën e kuvendeve të tjera.

Ka ndryshime në mes të legjislaturave, por jo në masë të madhe. E dyta është se në këtë mandat është shpallë Pavarësia e Kosovës, dhe faktori ndërkombëtar nuk i ka kompetencat që ka pasur më parë. Ai ka mund të shfuqizojë ligje të miratuara nga Kuvendi, dhe ka raste kur PSSP-ja i ka shfuqizuar. Ndërsa sot Kryetari i Kosovës mund ta kthej ligjin në Kuvend (sipas Kushtetutës dhe Rregullores së Kuvendit), ku do të plotësohej dhe prapë do të votohej në Kuvend). Këto janë dy specifika që i bëjnë të dallueshme legjislaturat.

## Rregullorja e re përshpejton miratimin e ligjeve

**Rregullorja e re parashihet që ta dinamizojë punën e Kuvendit, veçanërisht në shqyrtimin dhe miratimin e ligjeve. Si mund të arrihet kjo?**

Janë dy rregulla që ndikojnë, dhe sipas njërës, ndikon pozitivisht në përshpejtimin e dinamikës së miratimit të ligjeve në komisione. Në seancën e parë, të gjitha ligjet vijnë me kohë 10-12 ditë, eventualisht 15. Leximi i parë gjithëherë bëhet në afat dhe shpejt. Problemi është nga leximi i parë në të dytin. Komisionet të cilat i obligon Kuvendi për ta shqyrtuar ligjin që lexohet pas çdo leximi të parë në afat prej 60 ditësh, duhet t'i ofrojë Kuvendit amendamentet. Rregullorja e re do të ndikojë pozitivisht në përshpejtimin e procesit (të miratimit

të ligjeve), sepse ajo parasheh që Ligji kur të shqyrtohet në komision, në qoftë se nuk është përfaqësuesi i Ministrisë ose përfaqësuesi i sponsorizuesit të ligjit, hiqet nga rendi i ditës. Pra, kjo e obligon Ministrinë përkatëse që ta dërgojë përfaqësuesin, dhe pjesëmarrja e hartuesit e përshpejton dhe harmonizon ndryshimet e mundshme të ligjit, dhe i sjell më shpejt në leximin e dytë. Një rregull tjetër, që unë e Sabri Hamiti pak e kundërshtuam, është që ç'do ligj të kalojë nëpër Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore dhe Persona të Pa gjetur, (me arsytimin se çdo ligj ka të bëjë me të drejtat e njeriut). Ky është një rekomandim i Komisionit Evropian, por ne kemi rezerva këtu, sepse ky komision, që ka rolin e komisionit të përhershëm të rëndësishëm të Kuvendit të Kosovës, që do duhej të kalojë të gjitha ligjet për mes tije, mund të ndikojë në zvarritjen e miratimit ose shqyrtimin e ligjeve.

***Ekspertët për hartimin e ligjeve dhe krijimi i hapësirës së mjaftueshme për deputetët dhe administratën në Kuvend, janë dy nevoja imediate për Kuvendin. A mund të ketë gjatë këtij viti lëvizje pozitive në këtë drejtim?***

Unë mendoj se ndërtimi i ndërtesave që janë bërë për ministrinë dhe Qeverinë, dhe largimi i ministrive që i kanë zënë hapësirat në Kuvend, si dhe ndërtimi i Rezidencës Presidenciale të Presidentit, krijon hapësirë të mjaftueshme në Kuvend. Nëse këto ministri largohen nga Kuvendi, atëherë kemi hapësirë të mjaftueshme. Sepse në një aneks (në katin parë) të Kuvendit është Rezidenca e Presidentit të Kosovës, një aneks të tërë e shfrytëzon Ministria e Transportit, po ashtu Ministria e Drejtësisë, dhe në një aneks tjetër faktori ndërkombëtar. Duhet bërë më shumë në këtë drejtim siç është rasti me ndërtimet në Vila Gërmia, për të cilën unë kam qenë kryhen punët, dhe nëse ka shkelje ligjore të merret gjyqi me to, sepse kapacitetet i duhen Kosovës. Kështu që me largimin e këtyre kapaciteteve qeveritare dhe të Presidencës, do të krijohet hapësirë e mjaftueshme në Kuvend.

## **Roli i Kuvendit në çështjen e sigurisë**

***Për menaxhimin e situatës së sigurisë që nga shpallja e pavarësisë e këtej, ka vlerësime pozitive nga faktorët ndërkombëtarë. A pajtoheni me këto vlerësime?***

Siguria në aspektin e përgjithshëm për Kosovën është e mirë. Ne kemi pasur cenim të kufijve pas shpalljes së pavarësisë. Kemi pasur dy pika të djegura kufitare, Portën 1 dhe 31, ditët që u shpall Pavarësia. Me këtë rast kemi një reagim të ngathët të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare. Por në aspektin e përgjithshëm kur merret siguria, kur analizohen faktorët që ndikojnë në vlerësimin për sigurinë, që nga ndeshjet në komunikacion e deri te rastet e krimeve të rënda, mendoj që numri i tyre ka rënë shumë. Por kemi pasur disa raste të rënda për sigurinë e Kosovës siç është thyerja në dhomën e dëshmitë brenda një segmenti të policisë, gjë që është shumë shqetësuese. Siguria në parametrat mbi të cilët ndërtohet vlerësimi për sigurinë janë në ulje, por duhet të na shqetësojnë disa ngjarje me të cilat duhet të merremi.

***Njiheni si njohës i fushës së sigurisë. A mund të na thonë se cili është roli i Kuvendit sa i përket sigurisë në Kosovë?***

Mbikëqyrjen parlamentare, as një rol tjetër s'ka Kuvendi. Pra mbikëqyrjen parlamentare të segmenteve që kontrollojnë dhe kujdesen për sigurinë në Kosovë. Dhe kjo mbikëqyrje ka të bëjë me implementimin e ligjit dhe me shkeljen e të drejtave të qytetarëve të Kosovës. Mekanizmat e sigurisë, (që mund të jenë mekanizma represivë), të mos kalojnë kompetencat ligjore dhe për të mos bërë shkelje të të drejtave të qytetarëve. Këtë rol duhet ta ketë Kuvendi, rolin mbikëqyrës parlamentar të këtyre segmenteve.

## **Ndërtimi i kapaciteteve të sigurisë**

***Si e vlerësoni ecurinë e ndërtimit të mekanizmave të sigurisë së shtetit të Kosovës, që dalin edhe nga Pakoja e Ahtisarit?***

Pa thënë se jam opozitë, duhet pranuar faktin që janë ndërtuar ngadalë. Kemi pasur mos realizim të kompetencave që kanë pasur Qeveria dhe Presidenti. Themelimi i Agjencionit Kosovar të Intelejencës (AKI), ka qenë i afatizuar dhe Presidenti e Kryeministri emërojnë Drejtorin e AKI-së, me një vit vonesë. Megjithatë ndërtimi po kryhet, por dinamika e ndërtimit nuk është në përputhje me ligjin, sepse ligji e përkuftizon dinamikën për sa kohë duhet

ndërtuar këta mekanizma. Pra dinamika është shumë e ngadalshme. Me emërimet e larta të FSK-së, janë tejkaluar edhe kompetencat kushtetuese dhe ligjore, por ato megjithatë janë ndërtuar dhe po ndërtohen.

***Sipas Organizatës Freedom House, Kosova ka avancuar nga një shtet "jo i lirë" në "pjesërisht i lirë". Çfarë domethënie ka kjo për shtetin e Kosovës?***

Kjo është organizatë respektabile në botë që vlerëson sigurinë në të gjitha shtetet. Me rëndësi për ne është që ky avancim, nga jo i lirë, në pjesërisht i lirë, më së shumti i ka shkuar për shtati faktorit ndërkombëtar (misionit të tyre). Sepse sipas statusit të "jo i lirë" personeli merr shtesa mbi rrezikshmërinë e misionit. Faktori ndërkombëtar kurrë s'ka qenë i rrezikuar në Kosovë, as UNMIK-u, KFOR-i, e as EULEX-i, pra s'e kanë pasur rrezikshmërinë që e kanë pasur në Afganistan ta zëmë e vende tjera, por, shtesën për rrezikshmërinë e kanë marrë si në vendet tjera. Kjo është e mirë për shtetet që janë në proces të njohjes, dhe një argument në duart tona për të lobuar për njohje. Prandaj mund të themi se, ja Kosova po avancohet pas shpalljes së pavarësisë. Ky fakt duhet shfrytëzuar më shumë nga ne, sepse Kosova nuk po degradon, por po avancohet në sigurinë e vet dhe të rajonit.

***Zyrtarë të lartë ndërkombëtarë kanë thënë se Kosova nuk rrezikohet nga jashtë. Cili është mendimi juaj?***

Me ardhjen e KFOR-it në Kosovë, dhe me nënshkrimin e marrëveshjes së Kumanovës, dhe me humbjen që ka pësuar Serbia nga forcat e UÇK-së dhe NATO-s, është bërë e ditur se Kosova sdo të jetë e rrezikuar në aspektin fizik. Por, një shtet nuk rrezikohet vetëm kur shihen tanket dhe avionët e huaj në territorin e saj. Ka forma dhe metoda të tjera të cilat përdoren, jo për ta rrezikuar fizikisht (në këtë rast Kosovën) por për t'ia bërë të vështirë rrugën e zhvillimit dhe prosperitetit. Dhe në lidhje me këto metoda të sofistikuar Kosova është e rrezikuar nga ato segmente të Serbisë. Edhe kur të hyjmë në BE, së bashku me Serbinë si dy shtete të pavarura, Kosova duhet të ngritë kapacitetet që ta sigurojë vendin nga këto ndikime.

***Intervistoi: Ismet Mahmuti***

# NEWSBOOM

**Ramë Buja, kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës**

## Dua të jem i hapur



Ti drejtohes popullit tënd në një përvjetor si ky, kur ke marrë përsipër besimin e tij dhe detyrimin për ti shërbyer, është me të vërtetë një kënaqësi e madhe dhe obligim për mua që në emër të grupit parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës ti uroj gëzuar festën e Pavarësisë. Dhe natyrshëm kjo festë më rikthen mendimet në dy vitet që kaluan, në ngjarjet

më të rëndësishme apo në çastet më të spikatura që kanë shoqëruar Kosovën.

Në përpjekjet për të realizuar obligimet dhe qëllimet tona, në raportet me vetveten, shpallëm Kosovën; Shtet të Pavarur dhe Sovran, krijam dhe aprovaam Kushtetutën tonë ,dhe me aleatët e vendit mike si dhe organizatat ndërkombëtare, me të cilat ne po zhvillojmë marrëdhënie të ngushta dhe shumë miqësore, jemi anëtarë të dy institucioneve më të fuqishme të botës, Bankës Botërore dhe FMN-në. Gjithashtu kemi lidhje të fuqishme me SHBA-të, NATO-n dhe Bashkimin Evropian

Ndihem shumë krenarë, që Kosova edhe pse një shtet i ri, është bërë pjesë kontribuese e politikave, të stabilizimit, të sigurisë e të integritimit në Ballkanin Perëndimor. Ne kemi besim dhe bindjen, se rruga që kemi nisur po i shërben të ardhmes së përbashkët evropiane.

Ne duhet të jemi të ndërgjegjshëm se asgjë nuk dhurohet, gjithçka meritohet dhe fitohet me dinjitet. Ndaj duhet të vlerësojmë gjithçka dhe të plotësojmë të gjitha kërkesat që ofrojnë të gjitha vendet mike dhe organizatat prestigjioze Evropiane dhe ato ndërkombëtare.

Kemi realizuar trembëdhjetë seanca solemne në këto dy vjet, ku kemi pasur të ftuar personalitetet më në zë të politikës botërore, të cilët me këtë rast dua edhe ti përsëjdes dhe ti përgëzoj. Faleminderit për gjithçka. E me këtë rast edhe të gjithë ato personalitete të tjera, të gjitha ato vende mike që na janë gjendur pranë, të gjitha ato shtete që me njohjen e statusit tonë të ri, si Shtet i Pavarur dhe Sovran kanë pasur besimin dhe vlerësimin më të lartë për ne.

Të përsëjdes të gjitha ato institucione ndërkombëtare dhe Evropiane që ditë për ditë punojnë me ne për konsolidimin e Kosovës dhe institucioneve tona.

Dua të përsëjdes me këtë rast, të gjitha familjet e dëshmorëve që u martirizuan për këtë ditë, të gjitha ato familje që kanë humbur të dashurit e tyre dhe të gjithë qytetarët e Kosovës që në forma të ndryshme kanë dhënë kontributin e tyre. Ti siguroj ata se gjaku dhe përpjekjet e tyre janë obligimi më i madh yni për të realizuar gjithçka ata kanë ëndërruar dhe dëshiruar.

**Gëzuar Ditën e Pavarësisë**

**Lutfi Haziri, kryetar i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës**



Kam kënaqësinë tu drejtohem lexuesve dhe të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës, në prag të shënimit të dy vjetorit të shpalljes së Pavarësisë. Me këtë rast do të përgëzoja popullin e Kosoves, për arritjet e mëdha, si dhe për partneritetin e treguar gjatë këtij procesi .

Dy vite pas shpalljes, Shtet i Pavarur dhe Sovran, Kosova bëri

hapa të rëndësishëm për ngritjen e institucioneve stabile demokratike dhe dëshmuam se shteti ynë e ndihmon fuqishëm paqen dhe stabilitetin në rajon.

Para dy vitesh u realizua projekti më i madh që kishin synim shumë breza, një projekt që sot simbolizohet edhe me emrat e shume heronjve të mëdhenj të Kosovës e ne veçanti, dr. Ibrahim Rugova, lider shpirtëror dhe politik i pavarësisë.

Politika e vendit tonë është politikë e paqes. Ne punojmë çdo ditë që Kosova të bëhet pjesë e proceseve integruese euroatlantike. Integrimi dhe bashkimi me Unionin Evropian dhe me NATO-n, mbetet synimi themelor për të ardhmen e shtetit me të ri në botë.

Deri tash vendin tonë e kanë njohur 65 shtete, dhe nga viti i kaluar të ngarkuarit me punë të Republikës së Kosovës janë vendosur në shumë shtete, e kjo dëshmon marrëdhëniet e mira me të gjitha vendet, si me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimin Evropian dhe vendet e tjera nga të gjitha anët e globi.

Absolutisht për institucionet e Republikës se Kosoves sovranitetit është i pa diskutueshëm dhe ne jemi duke punuar për integrimin e të gjitha komuniteteve në institucionet dhe shoqërinë kosovare.

Kosova ndryshoi në këto dy vite duke pasur rezultate të dukshme në të gjitha fushat ligjore, ku sukcesi ynë është ngushtë i lidhur me funksionimin e shtetit ligjor në të gjitha segmentet e tij , ekonomike. Janë krijuar kushte të favorshme për investime te kapitalit te huaj në Kosove, është sigurua një mjedis i qëndrueshëm për biznese, sociale e arsimore.

Si rezultat i punës dy vjeçare të institucioneve të Republikës së Kosoves, Kosova u anëtarësua ne Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe ne Bankën Botërore. Shpresoj se këtë rrugë do ta ndjekim dhe se shpejti do te jemi të anëtarësuar edhe në shumë organizata të tjera që janë në të mire të gjithë qytetarëve te Republikës së Kosovës.

Në përvjetorin e dyte të pavarësisë së Kosovës, si Kryetar i GP të LDK-së përsëjdet me optimizëm arritjet e deritanishme të shtetit të ri, duke ftuar të gjithë qytetarëve e Republikës së pavarur të Kosovës që të punojmë bashkërisht që të arrijmë të gjitha objektivat tona që Kosovën ta bëjmë shtet me institucione demokratike, shtet prosperues dhe të zhvilluar, për të siguruar mirëqene të plotë për të gjithë qytetarët e vendit tonë.



# NEWSBOOM

**Ahmet Isufi nënkryetar i Grupit Parlamentar të AAK**

## Vendim historik që kërkon vetëmohim dhe përgjegjësi historike



Shpallja e Pavarësisë së Kosovës, ishte akti më i lartë historik për 100 vite me radhë, por edhe vendim i drejtë që reflekton vullnetin e popullit dhe që erdhi si rrjedhojë e një pune dhe sakrifice vetëmohuese të shumë gjeneratave. Kurrë nuk duhet të harrojmë, se për lirinë, që tani ne po e gëzojmë, shumë gjenerata dhe struktura shoqërore nga më të ndryshmet: si mësues, punëtorë, akademikë e luftëtarë të

lirisë kanë dhënë gjithçka nga vetvetja për të gëzuar këtë vendim që tani më shumë se kurrë kërkon vetëmohim dhe përgjegjësi historike. Shpallja e Pavarësisë ka rezultuar me pritje të larta nga qytetarët e vendit duke konsideruar se përgjegjësitë po kalojnë përfundimisht tek institucionet dhe qeveria e Kosovës dhe se zhvillimi ekonomik dhe social do të jetë agjenda primare. Megjithatë, edhe pas dy vitesh, 30 % e territorit të Kosovës nuk administrohet nga ne, sundimi i ligjit, lufta e vërtet kundër dukurive negative si korrupsioni dhe krimi i organizuar, zhvillimi ekonomik dhe mirëqenia e qytetarëve vazhdojnë të mbesin pengesa serioze për zhvillimin dhe integrimin e Kosovës në BE dhe NATO. Sot, dy vjet pas, Kosova nuk ka një agjendë të saktë për zhvillimin dhe mirëqenien e vendit tonë.

Më shumë se kurrë, institucionet e vendit duhet të jenë të vendosura të veprojnë për të neutralizuar të gjithë ata zëra skeptik që po mundoheshin ta pengojnë vendimin historik. Kosova i shpallur si shtet sovran, duhet të ndërtohet dhe zhvillohet mbi parimet e qeverisjes së mirë dhe qëndrueshmërisë si në aspektin politik, po ashtu edhe në atë ekonomik dhe ndërkombëtarë. Në shumë intervista para shpalljes së pavarësisë, kam theksuar se shpallja e pavarësisë së Kosovës ndihmon stabilitetin rajonal dhe në fakt kontribuon në gjenerimin e trendeve pozitive në Ballkan në procesin e integrimeve evropiane. Edhe sot, mendoj se ky konstatim është i drejtë.

Megjithatë, si përfaqësues të popullit në kuvend dhe si elitë politike në përgjithësi kemi obligim tu krijojmë mundësi evropianeve të rinj të Kosovës që të inkuadrohen në proceset politike dhe vendimmarrëse në vend. Është shumë e nevojshme që kjo gjeneratë e re e cila ka shumë shkathtësi dhe kapacitete të hyjë në funksion të agjendës kosovare për integrim dhe zhvillim.

Tashmë vetëm me vlera të dëshmuara, me njerëz të pastër dhe me vlera të reja, mund t'i japim drejtim me interes kombëtar dhe zhvillimor vendit tonë.

Urime dyvjetorin e pavarësisë gjithë popullit të Kosovës.

**Ibrahim Makolli, kryetar i Grupit Parlamentar të Aleanca Kosova e Re**

## Kosova ka shumë sfida përpara



Nëse nisemi nga aspekti politik, në këto dy vite Kosova ka ecur shumë përpara. Në krahasim me atë çka ka qenë dhe çfarë tash është, Kosova ka fituar Pavarësinë, e cila e ka çuar në një njohje pothuajse nga një e treta e OKB-se. Është pjesëtare e FMN dhe Bankës Botërore. Natyrisht si një vend i ri ajo e ka të vështirë të arrije suksese të menjëhershme.

Nëse nisemi në aspektin e rrugës në të cilën është orientuar Kosova është shumë mbrapa. Këtu e kam fjalën për institucionet evropiane e ndërkombëtare.

Sfida territoriale e Kosovës është një problem pasi një pjesë e popullsisë nuk e pranojnë lehtë këtë realitet, këtu e kam fjalën për situatën në veri të Mitrovicës, apo institucionet paralele serbe, në komunat me popullsi të përzier, ose vetëm serbe. Po kështu lënia larg procesit të liberalizimit të vizave e vështirëson shumë situatën e brishtë të krijuar të Kosovës.

Për zhvillimin ekonomik situata është e rëndë dhe për arsye shumë të pritshme. Si një vend i ri pa përvojë në njohjet ligjore dhe plagëve të shumta të trashëguara nga e kaluara, Kosova me shumë vështirësi po integrohet. Ne aktualisht jemi vetëm një shoqëri konsumi dhe është shumë e vështirë për tu integruar apo hyrë në treg me prodhimet tona pasi kërkohen standarde tepër të larta që natyrisht ne nuk i kemi.

Sfidë tjetër për institucionet tona është zbatimi i ligjit në vend, i cili ka probleme të mëdha, gjë që kërkon një transformim të plotë të institucioneve tona të drejtësisë, gjykatave dhe prokurorisë. Kemi deficite të krijuara në numrin e juristëve dhe përvojën e tyre në njohjen dhe zbatimin e legjislacionit të ri. Kushtetuta e re dhe një numër i madh i ligjeve të reja përëndimore nuk ka një trashëgimni dhe kjo sjell edhe kontradiktat e veta. Ndaj ka nevojë për shumë punë dhe përkushtim.

Me këtë rast në emër të grupit parlamentar të Partisë Aleanca Kosova e Re, u uroj qytetarëve të Kosovës Gëzuar ditën e Clirimit

# NEWSDOWN

## Lulzim Zeneli, kryetar i Grupit Parlamentar të LDD-së



Zakonishtë njeriu, nga çfarëdo pozite qoftë ai, është i lumtur kur bën një vlerësim paraprak të një viti që ka kaluar, në rastet kur ky vit mund të konsiderohet ose vlerësohet si i suksesshëm. Por, secili prej nesh, nuk mund ta ndjejë veten mirë, kur bën bilançin e vlerësimeve të përgjithshme për Kosovën e vitit 2009. Dhe fjalja e parë që të bie ndër mend është kjo: kaloi edhe një vit!

Në vitin 2009, Kosova u karakterizua me shumë zhvillime të gjithë mbarëshme por që nuk ishin pozitive ose dobiprurëse. Vazhdimi i një trendi keq qeverisës dhe i degradimit institucional, bën që Kosova ta kalojë vitin 2009 pa ndonjë optimizëm të madh. Qytetarët e Kosovës sot shpresojnë më pak se çkanë shpresuar vite më parë, shkalla e besimit të tyre në institucionet e vendit dhe në politikën përgjithësisht ka shënuar rënie të madhe. Shto këtu edhe faktin e ekzistimit të një rrjete të gjerë organizative të korrupsionit dhe manipulime në të gjitha nivelet. Kosova në 2009 pati një stabilitet të brishtë, me një gjendje sociale të rënduar, e cila edhe sot e kësaj dite është potencial i mjaftueshëm për shpërthim të pakënaqësive dhe trazirave sociale.

Në Kosovën e vitit 2009, niveli i zhvillimit të përgjithshëm ekonomik, ka shënuar rënie, po ashtu, kemi rënie të investimeve të huaja në masën deri në njëzetë për qind në krahasim me vitet tjera. Dhe krejt kjo mund të përkufizohet me vetëm një fjalë: regres.

Asnjë nga raportet dhe vlerësimet me rëndësi nga institucionet kredibile ndërkombëtare gjatë vitit 2009 nuk ka qenë pozitiv për Kosovën, madje, në asnjë sferë të vetme. Një sistem i drejtësisë, krejtësisht jofunksional dhe jo efikas, politizim i skajshëm i institucioneve të pavaruara, ndërhyrje e drejtpërdrejtë politike në mediat e lira, përpjekje për shantazhe dhe konflikte të hapura interesi, moszbatim të kushtetutës dhe ligjshmërisë janë vetëm disa nga faktet “e suksesit” të Kosovës për vitin 2009, të cilat nuk po i themi vetëm ne, por i kanë thënë të tjerët para nesh.

Me të gjitha këto që u thanë më lart, në vitin që e lamë pas, qytetarët e Kosovës vazhduan të jenë përsëri të izoluar dhe të kufizuar në të drejtën e tyre për të lëvizur lirshëm në vendet e BE-së.

Kosova, edhe vjet, me gjasë edhe sivjet, ka qenë dhe mbetet “zorrrë qorre” në Evropën Juglindore, duke humbur kështu shansin dhe mundësinë që të zë kohën dhe momentin e duhur

për pjesëmarrje në procesin e anëtarësimit në BE.

Qytetarët e Kosovës, edhe vjet edhe sivjet, vujanë të njëjtat pasoja të të qenurit qytetarë të një vendi “pa perspektive”. Mungesa e perspektivës që sot qytetarët e Kosovës e shohin çdo ditë nuk ka ardhë si rezultat i dëshirës apo vullnetit të vet qytetarëve, por si pasojë e politikës së keqe qeverisëse, politikë kjo që ka vënë interesat e veta personale, grupe dhe partiake para interesit shtetëror.

Ne, tash në fillim vit, kur ende e kemi të freskët kujtimin për vitin që lëmë pas, s’na mbetet gjë tjetër veç të urojmë, të shpresojmë për një vit të mbarë për Kosovën dhe qytetarët e saj.

## Xhezair Murati, kryetar i Grupi Parlamentar 7+

# Jemi pjesë e së tërës



Si grup parlamentar jemi përfshirë dhe integruar tërësisht si pjesë e së tërës. Ne kemi një pjesëmarrje intensive, si grup parlamentar, në përgatitjen e seancës së Pavarësisë. Kemi punuar gjithashtu në aprovimin e dokumentave Ahtisaari të cilat janë edhe baza mbi të cilën jemi mbështetur për integrimin tonë dhe zhvillimin e Kosovës. Gjithashtu kemi punuar si pjesë përbërëse e grupit të punës dhe

kemi aprovuar Kushtetutën.

Mbi këto baza mendoj se Komunitetet po gjejnë vetveten në integrimin mbarë qytetar të Kosovës. Janë Realizuar një pjesë e mirë e lirive dhe të drejtave të këtyre komuniteteve. Megjithatë ka vështirësi në realizimin e disa të drejtave për të cilat ne po luftojmë dhe jemi në prag të arritjes.

E kam fjalën për procesin e decentralizimit të institucioneve, dhe ndërtimin e disa komunave me përbërje kryesisht Boshnjake.

Po kështu Arsimimi dhe përdorimi i gjuhës boshnjake në shkolla, e cila është një nga objektivat tona për tu arritur. Hapja e universitetit të Prizrenit do të krijonte një klimë mjaft të mirë për ne, pasi jeton një pjesë e mirë e pakicave boshnjake, turke, etj.

Punësimi është problem themelor dhe një parakusht i vendosur prej nesh, si një mundësi në parandalimin dhe ndërprerjen e emigrimit të popullsisë tonë nga Kosova.

***Ua urojmë Gëzuar Ditën e Pavarësisë të gjithë qytetarëve të Kosovës***



# *Ju Faleminderit*





# GJND-ja s' do ta kthejë procesin prapa

**Ekspertë të së Drejtës Kushtetuese dhe asaj Ndërkombëtare, vlerësojnë se procesi dëgjimor në GJND rreth shqyrtimit të legalitetit të shpalljes së pavarësisë së Kosovës, është përshkruar nga zhvillime interesante dhe ballafaqim argumentesh pro dhe kundër. Sipas tyre, në fund gjykatësit mund të mblidhen më tepër rreth një komenti përshkrues, i cili nuk do të ketë efekt juridik. Ata përjashtojnë kthimin prapa të procesit**

Pas një procesi të gjatë negociator për statusin e Kosovës dhe pas shterimit të të gjitha mundësive për të gjetur një zgjidhje kompromisi ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit, fillimi i vitit 2008 çoi në shpalljen e pavarësisë së Kosovës. Kjo shpallje e cila u pasua me njohje nga shtetet më të fuqishme të botës demokratike, ashtu edhe siç pritej, u kundërshtua nga ana e Serbisë. Për të penguar vazhdimin e mëtejshëm të njohjes së pavarësisë, Serbia përdori mjete të ndryshme, përfshirë edhe kërkesën për një mendim këshilldhënës në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë, rreth legalitetit të shpalljes së saj nga ana e institucioneve të Kosovës.

Pas votimit në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së, Gjykata filloi procesin. Më 1 dhjetor 2009 filluan seancat dëgjimore me paraqitjen e qëndrimeve të palëve, Prishtinës dhe Beogradit, së bashku me mbrojtësit e tyre. Për nëntë ditë, 27 shtete paraqitën qëndrimet e tyre, 14 në favor të pavarësisë së Kosovës, 12 kundër saj, ndërsa një mbajti qëndrim të balancuar.

## Nëntë ditët e GJND-së

Në ditën e parë, përfaqësuesit e Kosovës dhe ata të Serbisë, paraqitën qëndrime të kundërta rreth legjitimitetit të shpalljes së pavarësisë. Delegacioni nga Kosova, deklaratën e pavarësisë e cilësoi në harmoni me të drejtën ndërkombëtare, bazuar në parimin e vetëvendosjes, ndërsa delegacioni serb e quajti këtë deklaratë si të paligjshme, bazuar në Rezolutën 1244. Qëndrimin e Kosovës e paraqiti dhe e mbrojti Ministri i punëve të Jashtme, Skënder Hyseni, së bashku me tre ekspertë ndërkombëtarë, Majkëll Vud, Daniel Myller dhe Shon Marfi. Ndërsa, delegacioni i Serbisë u udhëhoq nga ambasadori i këtij vendi në Francë Dushan Batakoviç.

Seancat dëgjimore vijuan për nëntë ditë me radhë, me paraqitjen e shteteve të ndryshme. Legjitimitetin dhe ligjshmërinë e shpalljes së pavarësisë së Kosovës e mbështetën: Shqipëria, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Gjermania, Britania e Madhe, Franca, Arabia Saudite, Austria, Bullgaria, Kroacia, Danimarka, Holanda, Norvegjia, Finlanda dhe Jordania.

Ndërsa, qëndrimin e Serbisë: Rusia, Kina, Spanja, Brazili, Argjentina, Azerbajxhani, Bjellorusia, Bolivia, Rumania, Qipro, Venezuela dhe Vietnam.

## Përpyekja e fundit e Beogradit

Eksperti i së Drejtës Kushtetuese, **Arsim Bajrami**, e sheh këtë proces si përpyekje të fundit të regjimit të Beogradit për të penguar ecjen përpara të shtetit të Kosovës, dhe për të vonuar procesin e njohjes ndërkombëtare. Sipas tij, në aspektin ligjor dhe kushtetues, ky është një proces i



humbur për Serbinë, sepse të gjitha dokumentet legale ndërkombëtare dhe politike argumentojnë arsyeshmërinë e shpalljes së pavarësisë së Kosovës.

Bajrami thotë se shpallja e pavarësisë ka qenë një akt logjik i përfundimit të një procesi të gjatë të zgjidhjes së statusit të Kosovës,

dhe një rast i mirë i menaxhimit ndërkombëtar të një krize që ka eskaluar në shkallë lufte.

Ai thotë se Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë ka prova të mjaftueshme për të dhënë një mendim pozitiv, sipas të cilit shpallja e pavarësisë së Kosovës ka qenë një hap i koordinuar, i cili nuk është në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare. Ngase, sipas tij, pavarësia e Kosovës nuk paraqet një akt të zhvendosjes së kufijve apo një rast të secesionit territorial, sepse Kosova, që nga përfundimi i Luftës së Dytë Botërore, kishte këta kufij administrativë. Ajo, mbi bazën e tyre ka deklaruar pavarësinë, si një akt legjitim të popullit të saj dhe akt përfundimtar i zgjidhjes së tërë krizës që ka pasuar në këtë pjesë të Ballkanit, si rezultat i shthurjes së ish-Jugosllavisë dhe luftërave që ka bërë Serbia. Duke pasur parasysh këtë, prof. Bajrami thotë se GJND-ja do të marrë parasysh realitetin faktik, dhe ky realitet është që Kosova tashmë është shtet i njohur ndërkombëtarisht nga 65 shtete, dhe shtetet që e kanë njohur atë janë subjektet kryesore të së drejtës ndërkombëtare.

“E drejta ndërkombëtare nuk është statike, pra nuk është e kohës së Luftës së Ftohtë, por është e drejtë ndërkombëtare e një rendi të ri botëror, vlera universale të të cilit janë të drejtat e njeriut dhe liria e çdo kombi. Mbi bazën e këtyre parimeve, Kosova ka qenë një rast pozitiv, dhe deklarimi i rasti të Kosovës si një rast sui-generale, ka qenë një strategji e mirë për të ndaluar presedanat eventuale, që nuk kanë lidhje me rastin e Kosovës”, thotë Bajrami. Sipas tij, rasti i Kosovës është rast edhe i vetëvendosjes, edhe i shthurjes së një shteti, gjithashtu edhe rast i suksesshëm i zgjidhjes së konfliktit shqiptaro-serb, mbi bazën e konfliktit territorial.

Eksperti Arsim Bajrami vë në pah se vet sukcesi që e ka arritur Republika e Kosovës duke qenë faktor stabiliteti në rajon, ka treguar më së miri se ka qenë zgjidhja më optimale e mundshme.

Të gjithë këta faktorë, thotë ai, do t'i marrë parasysh Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, e cila, sipas Bajramit, do të japë një opinion neutral, që do ta mbyll aspektin legal të kontestimit të pavarësisë nga ana e Serbisë dhe do të jetë një shtytje përpara e procesit të njohjes së pavarësisë së Kosovës.

## Ndikimi i procesit në njohjen e pavarësisë

Eksperti i së Drejtës Ndërkombëtare, Afrim Hoti, thotë se procesi para Gjykatës Ndërkombëtare ishte pengesa e radhës e bërë



nga Serbia në rrugën e shtetformimit të Kosovës, dhe ky proces, ndonëse jo pa komplikime, duket se nuk do të ketë implikime serioze në rrugën e Kosovës. Ai thotë se procesi dëgjimor në Gjykatë është përshkruar nga zhvillime interesante dhe ballafaqim argumentesh pro dhe kundër legalitetit të shpalljes së pavarësisë. Hoti shprehet i impresionuar me argumentet pro pavarësisë, sidomos nga disa shtete,

ndonëse sipas tij, edhe përgatitjet dhe paraqitja e Kosovës meriton lëvdata dhe respekt. Argumentet kundër kanë qenë të njohura dhe më shumë si konstruksione të cilësuar si boshe dhe fiktive për zhvillimet moderne të së drejtës ndërkombëtare, potencon ai.

Duke folur rreth synimit që Serbia ka dashur ta arrijë me iniciimin



e këtij procesi, Afrim Hoti thotë se është vlerësim i drejtë fakti se Serbia ka pretenduar ngadalësimin e njohjeve, mbase edhe pengimin e tyre, ashtu siç është konkludim i drejtë që ky synim deri në një masë është arritur. Ai thotë se viti i kaluar u përshkua me një numër simbolik i njohjeve. Sipas tij, periudha e tanishme kohore është periudhë e dëshimit të Kosovës para komunitetit ndërkombëtar. “Kur e përmend fjalën dëshim, nënkuptoj faktin që Kosova duhet të argumentoj para botës që lindja e saj është realitet dhe që ky realitet nuk mund të injorohet. Kjo është periudha më e vështirë e Kosovës për të siguruar njohjet në këto rrethana, ngase tashmë kërkojmë njohje nga shtete të cilat ose nuk kanë ndonjë interes të marrin një vendim të tillë, ose për marrjen e këtij vendimi kanë dilema të caktuara. Dhe, procesi para GJND-së shërben si argument apo justifikim për të shtyrë ose evituar marrjen e vendimit për njohjen”, thekson Hoti.

### ***Intensifikimi i njohjeve***

Edhe Arsim Bajrami potencon se duhet pranuar fakti që ky proces në Gjykatën Ndërkombëtare ka pasur një ndikim në tempon e njohjeve, sepse GJND-ja është një produkt i Kombeve të Bashkuara, dhe shtetet që e kanë votuar Rezolutën me të cilën kërkohet mendimi këshilldhënës, kanë dashur ta respektojnë këtë institucion ndërkombëtar. Kjo arsyetohet me faktin se kanë hezituar ta bëjnë njohjen e pavarësisë, derisa zhvillohet procesi në GJND, përkundër faktit që Kosova ka pasur njohje, madje shumë të rëndësishme, siç janë ato nga shtetet fqinje.

Por, Bajrami thotë se përfundimi i këtij procesi që do të bëhet gjatë kësaj vere, do të jetë aduti i fundit serb. Ai thotë se pritet të ketë një intensifikim të njohjeve dhe Kosova të ketë numër të mjaftueshëm njohjesh, sa për të proceduar kërkesën, ndoshta këtë vjeshtë, për shqyrtimin e mundësisë së anëtarësimit të saj në Kombet e Bashkuara. “Pas kësaj kërkesë, sigurisht që shumë shtete të ashtuquajtura legaliste, do të mund të fillonin me procedurën e njohjes së pavarësisë së Kosovës. Më së miri do të ishte që kjo të ndodhte me këto pesë shtetet e Bashkimit Evropian”, thotë Bajrami.

### ***Çfarë qëndrimi për pavarësinë do të mbajë Gjykata?***

“Mendoj që duhet të përjashtohet mendimi negativ nga ana e

Gjykatës, sepse ajo do të binte ndesh me komplet rendin e ri botëror dhe me komplet të drejtën ndërkombëtare moderne. Mos të harrojmë se kjo Gjykatë është kreacioni i Kombeve të Bashkuara, kurse të gjitha shtetet që e kanë pranuar pavarësinë e Kosovës, janë anëtare, e disa edhe themeluese të kësaj organizate”, thotë eksperti kushtetues, Arsim Bajrami. Sipas tij, për të krijuar një unitet legal, gjykatësit mund të mblidhen më tepër rreth një komentari përshkrues, me ç’rast ata do të konstatojnë se pavarësia e Kosovës është shpall dhe është njohur. Bajrami parasheh që në të, të përmendet edhe procesi i Rambujesë, i cili është pasuar me bombardimet e NATO-s pa mandatin e Këshillit të Sigurimit.

“Mendoj që përfundimisht do të japin një konkludim, ku do të thuhet se ky është një rast i veçantë, dhe do t’ia lënë shteteve individualisht të gjykojnë nëse duhet të pranohet ose jo. Mendoj që ose do të jetë ky opsion ose nuk do të ketë fare koment.

Vendimi nuk do të jetë rigjid, pra s’do të jetë i ngurtë ose i kodifikuar, por do të jetë një koment i përgjithshëm në të cilin ata do të konstatojnë konkluzionet e mbrojtjes së delegacionit të Kosovës, të cilat janë të fuqishme, kundërshtimet e Beogradit, dhe në fund do të nxjerrin disa konkluzione me të cilat do të përfundojnë mandatin e marrë nga Asambleja e Përgjithshme”, thotë Arsim Bajrami, duke përjashtuar çfarëdo mundësie të rikthimit të procesit prapa.

### ***Mendimi i GJND-së, pa efekt juridik***

“Do ishte spekulative të prejudiohej vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare, porse duke marrë parasysh natyrën e kërkesës serbe dhe formatin e procesit në këtë Gjykatë, jam shumë i bindur që opinioni i dhënë nga gjykata do të jetë gjithëpërfshirës dhe i atillë që do të reflektojë pozicionet dhe argumentet e deklaruara pro dhe kundër”, thekson nga ana e tij Afrim Hoti. Ai shfaq mendimin se opinioni nuk do të përshkohet me terma absolut. Sipas tij, është krejtësisht e qartë që ky opinion nuk do të ketë ndonjë efekt juridik, ndonëse të gjitha efektet e saj po dëshmojnë të jenë politike për momentin dhe do të vazhdojnë të jenë të së njëjtës natyrë me ritme edhe më të mëdha pas publikimit të tij.

Paneli i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, i përbërë prej 15 gjykatësish, të cilët vijnë nga vende që e kanë pranuar pavarësinë e Kosovës dhe nga vende që ende refuzojnë ta njohin, parashihet që të dalë me qëndrimin e tij brenda pak muajsh.

***Musli Krasniqi***

1.	FLORA BRONVINA	PDK	Flora Bronvina
2.	Nova Eritoku	PDK	Nova Eritoku
3.	SALA BEJSHA-SHAH	NL	Sala Bejshe
4.	Jafër Haderegani	PDK	Jafër Haderegani
5.	KADUHA JASHARI	PSDK	Kaduha Jashari
6.	ZAFIR BERISHA	PDK	Zafir Berisha
7.	ADEM GRABOVCI	PDK	Adem Grabovci
8.	Vlora Kadrija	SLS	Vlora Kadrija
9.	Kocapa J. Kuvendi	ES	Kocapa J. Kuvendi

10.	Amira		
11.	Donika		
12.	Yezir		
13.	Shirvan		
14.	Majlinda		
15.	Ulir		
16.	Julijana		
17.	Enxhet		
18.	Vendi		
19.	Enxhet		
20.	Riza		
21.	EMR		
22.	SAN		
23.	ARMAN		
24.	ORON		
25.	Shirvan		
26.	BURJA		
27.	Enxhet		
28.	Enxhet		
29.	Enxhet		
30.	Enxhet		
31.	Enxhet		
32.	Enxhet		
33.	ORA		
34.	DETA		
35.	SANA		
36.	SANA		
37.	SANA		
38.	SANA		
39.	SANA		
40.	SANA		
41.	SANA		
42.	SANA		
43.	SANA		
44.	SANA		
45.	SANA		
46.	SANA		
47.	SANA		
48.	SANA		
49.	SANA		
50.	SANA		

1.	FLORA BRONVINA	PDK	Flora Bronvina
2.	Nova Eritoku	PDK	Nova Eritoku
3.	SALA BEJSHA-SHAH	NL	Sala Bejshe
4.	Jafër Haderegani	PDK	Jafër Haderegani
5.	KADUHA JASHARI	PSDK	Kaduha Jashari
6.	ZAFIR BERISHA	PDK	Zafir Berisha
7.	ADEM GRABOVCI	PDK	Adem Grabovci
8.	Vlora Kadrija	SLS	Vlora Kadrija
9.	Kocapa J. Kuvendi	ES	Kocapa J. Kuvendi

## Flora Bronvina

# Më shumë barazi dhe përgjegjësi

Grupi Joformal i Deputeteve të Kuvendit të Kosovës, në funksion të fuqizimit të gruas në politikë dhe vendimmarrje, ka punuar dhe ka shtruar kërkesën për amendamentimin e ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Deputetet, që në fillim nuk e kanë parë veten në pozitë të barabartë dhe e kanë shprehur këtë. Ato mendojnë, se votimi për subjektin politik dhe vetëm për një kandidat, nuk është shans për gruan. Kësaj marginalizohet roli i gruas në politikë dhe vendim marrje dhe favorizohet roli i liderit të partisë dhe i një kandidati që zakonisht është mashkull. Ato kërkojnë që të sigurohet kuota sikur është paraparë me Ligj por në anën tjetër edhe cilësia e përfaqësimit, konkurrenca reale dhe marrja e përgjegjësi ndaj votuesve. Propozimi për plotësimin e Nenit 110, paragrafi 4 ku në vend që të votohet për një kandidat, të votohet për gjashtë (6) është një shanc për gruan por mundëson edhe një përgjegjësi të shtuar për të si deputete. Ky ndryshim shpreh vetëdijen e gruas në politikë për të konkurruar dhe për të qenë e zgjedhur më votë e jo të hyjë vetëm në bazë të kuotës së garantuar. Grupi i Grave Parlamentare ka pritur afatin ligjor për të nisur procedurën për ndryshimin e këtij Ligji, që është gjashtë muaj pas nënshkrimit të Ligjit nga ana e Presidentit të Republikës së Kosovës.

Janë organizuar disa takime dhe debate më këtë temë. Një takim është mbajtur në Gjakovë me gratë asambleiste dhe të shoqërisë civile, një tjetër në Gjilan, ku ideja ka hasë në përkrahje të plotë. Është organizuar një tryezë debutoese, ku kanë marrë pjesë kryetarët e Grupeve parlamentare, përfaqësuesit e Zyrave të huaja në Prishtinë,

përfaqësuesit e organizatave që mbështesin punën e Kuvendit, shoqëria civile, ku është folur gjerë e gjatë pse duhet bërë ky ndryshim i Ligjit Zgjedhor.

Ligji zgjedhor i takon Ligjeve të "Pakos" së Ahtisarit dhe ligjet nga kjo "Pako" vështirë të ndryshohen, por ky ndryshim i propozuar vetëm e plotëson Ligjin në fjalë duke e fuqizuar rolin e gruas në politikë dhe vendimmarrje, u tha pos të tjerash në tryezën e mbajtur në maj të 2009 të organizuar nga Grupi i Grave deputete. Gratë deputete ishin unanime në kërkesën e tyre dhe kërkuan mbështetjen e shoqërisë civile, grave në politikë, të grave të zgjedhura në Asamblatë Komunalë. Krahas kësaj, ato zhvilluan një lobim të fortë edhe te kolegët e tyre deputet duke kërkuar mbështetje nga secili veç e veç, pa dallim partiak dhe përkatësi nacionale. Kësaj kerkese iu bashkangjiten 83 deputetë me nënshkrimet e tyre. Edhe pse për të nisur procedurën mund të mjaftonin edhe gjashtë. Qëllimi i mbledhjes së nënshkrimeve ishte që ato të sigurohen realisht në përkrahjen e idesë e cila nuk vlen vetëm për gratë por për të gjithë.

Zgjedhjet e porsa mbajtura lokale i dhanë edhe më shumë arsyeshmëri kësaj kerkese, pasi shumica e grave hyn në Asamblatë Komunale vetëm e vetëm falë kuotës me një numër herë herë qesharake të votave.

Deputetet do të llojnë dhe do të jenë këmbëngulëse, të argumentuara që të kenë sukses në amendamentimin e Ligjit Zgjedhor dhe kërkesa e tyre po pret shumë gjatë për tu shqyrtuar në Parlament, por janë të sigurt se ky ndryshim i amendamentit të propozuar do të ndodhë në një nga seancat e ardhshme të Kuvendit të Kosovës.

51.	SANA		
52.	SANA		
53.	SANA		
54.	SANA		
55.	SANA		
56.	SANA		
57.	SANA		
58.	SANA		
59.	SANA		
60.	SANA		
61.	SANA		
62.	SANA		
63.	SANA		
64.	SANA		
65.	SANA		
66.	SANA		

67.	YOSVENS VLAPOVIC	ODS	Bugli
68.	HAZLE AMIDIJI	PDK	HAZLE AMIDIJI
69.	DRAG SHANKAJ	LS	DRAG SHANKAJ
70.	ORON		
71.	ORON		
72.	MARSHALL BEUTS	PDK	MARSHALL BEUTS
73.	DANIEL ALIJI	PDK	DANIEL ALIJI
74.	HATIRI ALIJI	PDK	HATIRI ALIJI
75.	JAHJA HAJRIZI	PDK	JAHJA HAJRIZI
76.	MIRASHATI HULAJ	PDK	MIRASHATI HULAJ
77.	MIRASHATI HULAJ	PDK	MIRASHATI HULAJ
78.	SHERIFAT GUSKAL	AKR	SHERIFAT GUSKAL
79.	SHERIFAT GUSKAL	AKR	SHERIFAT GUSKAL
80.	SHERIFAT GUSKAL	AKR	SHERIFAT GUSKAL
81.	SHERIFAT GUSKAL	AKR	SHERIFAT GUSKAL
82.	SHERIFAT GUSKAL	AKR	SHERIFAT GUSKAL
83.	SHERIFAT GUSKAL	AKR	SHERIFAT GUSKAL
84.	SHERIFAT GUSKAL	AKR	SHERIFAT GUSKAL

67.	YOSVENS VLAPOVIC	ODS	Bugli
68.	HAZLE AMIDIJI	PDK	HAZLE AMIDIJI
69.	DRAG SHANKAJ	LS	DRAG SHANKAJ
70.	ORON		
71.	ORON		
72.	MARSHALL BEUTS	PDK	MARSHALL BEUTS
73.	DANIEL ALIJI	PDK	DANIEL ALIJI
74.	HATIRI ALIJI	PDK	HATIRI ALIJI
75.	JAHJA HAJRIZI	PDK	JAHJA HAJRIZI
76.	MIRASHATI HULAJ	PDK	MIRASHATI HULAJ
77.	MIRASHATI HULAJ	PDK	MIRASHATI HULAJ
78.	SHERIFAT GUSKAL	AKR	SHERIFAT GUSKAL
79.	SHERIFAT GUSKAL	AKR	SHERIFAT GUSKAL
80.	SHERIFAT GUSKAL	AKR	SHERIFAT GUSKAL
81.	SHERIFAT GUSKAL	AKR	SHERIFAT GUSKAL
82.	SHERIFAT GUSKAL	AKR	SHERIFAT GUSKAL
83.	SHERIFAT GUSKAL	AKR	SHERIFAT GUSKAL
84.	SHERIFAT GUSKAL	AKR	SHERIFAT GUSKAL

67.	YOSVENS VLAPOVIC	ODS	Bugli
68.	HAZLE AMIDIJI	PDK	HAZLE AMIDIJI
69.	DRAG SHANKAJ	LS	DRAG SHANKAJ
70.	ORON		
71.	ORON		
72.	MARSHALL BEUTS	PDK	MARSHALL BEUTS
73.	DANIEL ALIJI	PDK	DANIEL ALIJI
74.	HATIRI ALIJI	PDK	HATIRI ALIJI
75.	JAHJA HAJRIZI	PDK	JAHJA HAJRIZI
76.	MIRASHATI HULAJ	PDK	MIRASHATI HULAJ
77.	MIRASHATI HULAJ	PDK	MIRASHATI HULAJ
78.	SHERIFAT GUSKAL	AKR	SHERIFAT GUSKAL
79.	SHERIFAT GUSKAL	AKR	SHERIFAT GUSKAL
80.	SHERIFAT GUSKAL	AKR	SHERIFAT GUSKAL
81.	SHERIFAT GUSKAL	AKR	SHERIFAT GUSKAL
82.	SHERIFAT GUSKAL	AKR	SHERIFAT GUSKAL
83.	SHERIFAT GUSKAL	AKR	SHERIFAT GUSKAL
84.	SHERIFAT GUSKAL	AKR	SHERIFAT GUSKAL



Grupi i Grave Deputete organizoi ceremoni me rastin e ndarjes së mirënjohjeve për gratë më të suksesshme të vitit 2009

# Mirënjohje iu takuan 16 grave dhe institucioneve

**Këtë ceremoni e përshëndeti edhe kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, dr. Jakup Krasniqi, i cili tha se realiteti i krijuar në Kosovë është fryt edhe i kontributit të gruas gjatë gjithë historisë**

Grupi Joformal i Grave Deputete të Kuvendit të Kosovës, mbështetur nga OSBE-ja dhe NDI-ja, organizoi sot një ceremoni në ambientet e Kuvendit, në shenjë mirënjohjeje për gratë që dhanë kontribute të veçanta në avancimin e pozitës së gruas në shoqërinë kosovare. Në këtë solemnitet, të cilin e kryesoi Flora Brovina, kryetare e bordit, mori pjesë edhe kryetari i Kuvendit të Kosovës, dr. Jakup Krasniqi.

Duke hapur këtë ceremoni të ndarjes së mirënjohjeve për gratë më të suksesshme të vitit 2009, Flora Brovina theksoi se Grupi Joformal i Grave Deputete përbëhet nga 37 deputete të të gjitha nacionaliteteve. Ky grup ka arritur të ndërtojë dialogun ndërpartiak e ndërnacional, me qëllim të realizimit të fuqizimit të gruas në politikë dhe vendimmarrje. Në vijim ajo foli për kontributin e këtij grupi në monitorimin dhe amendamentimin e ligjeve., si: Ligji për barazi gjinore, Ligjin e trashëgimisë, Ligjin e punës, Ligjin për mbrojtje në punë, Ligjin për dhunën në familje etj.

Ideja për t' u tubuar sot, tha Flora Brovina, ishte ndarja e mirënjohjeve për gra të dalluara gjatë vitit, që lindi në terren, atje ku shihen konkretisht kontributet e grave. Lista e grave që merituan mirënjohje ishte shumë e gjatë, por asnjëra prej tyre nuk u harrua. Listën e grave dhe institucioneve që morën këto mirënjohje e bëri Bordi i Grave Deputete, ndërsa kjo nismë për ndarjen e mirënjohjeve do të jetë tradicionale. Flora Brovina tha se disa propozime do

t' i dërgohen edhe presidentit të Kosovës, në mënyrë që në listën e të dekoruarave nga presidenti, që u fillua me Yllin grua-Xhevë Krasniqi – Lladrovcin, të jenë edhe gra të tjera.

Këtë ceremoni e përshëndeti edhe kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, dr. Jakup Krasniqi, i cili njëherësh falënderoi Grupin e Grave Deputete për ndërmarrjen e kësaj nisme për të vlerësuar punën e grave më të suksesshme. Realiteti i krijuar në Kosovë, theksoi Jakup Krasniqi, është fryt edhe i kontributit të gruas gjatë gjithë historisë, gjatë kohës së luftës, si dhe ndërtimit të demokracisë. Në kuadër të ndarjes së mirënjohjeve krye parlamentar Krasniqi u dhuroi mirënjohjet artistes së madhe të skenës shqiptare, Leze Qena dhe Igballe Rugovës (Rrjeti i grupit të grave të Kosovës). Mirënjohjet tjera grave dhe institucioneve më të suksesshme u dhuruan nga ana e kryetares Brovina dhe anëtarëve të tjera të Bordit të deputeteve.

Mirënjohje dhe falënderime për vitin 2009 iu takuan gjithsej 16 grave dhe institucioneve të ndryshme të Kosovës dhe institucioneve ndërkombëtare, përkatësisht edhe Majlinda Kelmendit, bartëse e çmimit botëror për mundje, Afërdita Saraçinit, drejtoreshë e RTV 21, Linda Shalës, afariste, OJQ-ve “Medika Kosova”, “Norma”, “Jeta”, “Dera e hapur”, “Të vejave të Krushës” “Jeta –Vita”, si dhe Milka Koliqit dhe Myzefa Terziqit. Ndërsa, falënderime iu takuan OSBE-së dhe NDI-së.



# Me ligj - edhe më afër mërgatës

**Projektligji për Mërgatën është shumë i nevojshëm, sepse krijon një kornizë ligjore të domosdoshme për të ndikuar në ruajtjen e identitetit kulturor, gjuhësor dhe arsimor të pjesëtarëve të mërgatës dhe krijon lidhje të përhershme dhe të qëndrueshme me institucionet e Republikës së Kosovës**

Projektligji për Mërgatën e Kosovës ka zgjuar interesim të gjerë te deputetët, nisur nga fakti se me këtë projekt krijohet bazë për ruajtjen dhe kultivimin e identitetit gjuhësor, kulturor e arsimor të pjesëtarëve të mërgatës dhe lidhshmërinë e tyre me institucionet e Republikës së Kosovës. Ligji do të ndihmojë në organizimin e mërgatës kosovare në shtetet e ndryshme, ku jeton ajo.

Në shqyrtimin e parë të këtij Projektligji në Kuvendin e Kosovës të gjitha grupet parlamentare në parim e përkrahën Projektligjin, por u bënë edhe vërejtje e sugjerime. Duke folur në emër të Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, **Agim Veliu**, theksoi se gjatë diskutimit në këtë Komision janë përmendur edhe të metat e këtij projektligji, që herë-herë prekin edhe çështje përmbajtësore, siç janë definicioni i statusit mërgatë-diasporë, kostoja financiare dhe rreziku i paralelizmave me ambasadat e Republikës së Kosovës.

## *Projektligji rregullon themelimin e qendrave kulturore për Kosovën në mërgatë*

Projektligji është strukturuar në 17 nene, të cilat rregullojnë organizimin e Agjencisë së Mërgatës së Kosovës, përkatesisht Zyra për Çështje Jorezidente shndërrohet në Agjenci për Mërgatën, me shpresë se një ditë do të kemi edhe ministri, e cila do të merret me çështje të mërgatës, theksoi **Drita Kadriu**. Gjithashtu, ky Projektligj rregullon themelimin e qendrave kulturore për Kosovën në mërgatë. Fillimisht janë dy qendra gjithsej, me shpresë që këto të jenë edhe më shumë, për t'i përbushur nevojat e mërgatës. Ligji gjithashtu rregullon përkrahjen e mësimin dhe të avancimit të gjuhëve zyrtare të Kosovës në mërgatë.

**Gjylnaze Sylja** pohoi se ndërtimi i shtetit të Kosovës kërkon patjetër edhe krijimin e lidhjeve institucionale me mërgatën. Është me rëndësi që Projektligji të mbrojë edhe interesat e mërgatës. Projektligji duhet të jetë në funksion të mbrojtjes së mërgatës dhe të përfaqësimit të interesave të saj.

Megjithatë, pjesa më e madhe e Projektligjit për nga përmbajtja është më shumë e fokusuar në lidhjet kulturore, arsimore dhe sportive. Është vetëm një nen që flet për lidhjet ekonomike, ndërsa sa i përket ndërtimit të partneritetit në mes mërgatës dhe institucioneve, janë paraparë dy mekanizma, një është Agjencioni ekzekutiv në Kryeministri dhe tjetra është Qendra Kulturore e Kosovës për Mërgatën.

Sipas Projektligjit, parashihet që në të vërtetë Zyra, e cila e ka kryer funksionin e bashkëpunimit me mërgatën, Zyra për Çështje Jorezidente, tani të shndërrohet në agjenci ekzekutive, e cila udhëhiqet nga drejtori. Por, sa i përket ndërtimit, funksionimit të qendrës kulturore, që gjithashtu udhëhiqet nga drejtori që zgjedhet nga Kryeministri, mendoj se duhet një zgjidhje tjetër, konsideroj se drejtori duhet

ligjore të domosdoshme për të ndikuar në ruajtjen e identitetit kulturor, gjuhësor dhe arsimor të pjesëtarëve të mërgatës dhe krijon lidhje të përhershme dhe të qëndrueshme me institucionet e Republikës së Kosovës.

Mërgata për shumë dekada ka ndihmuar popullin e Kosovës, andaj edhe institucionet e shtetit më të ri në botë duhet të përkujdesen dhe të ndihmojnë pjesëtarët e mërgatës me të gjitha format e mundshme.



të zgjedhet nga diaspora, pasi ai duhet të përfaqësojë interesat e diasporës.

Edhe pse me legjislacionin evropian nuk rregullohet kjo fushë, meqenëse është lënë në kompetencë të shteteve të veçanta, nëpërmjet komunikatave theksohet rëndësia e mërgatës në dërgimin e mjeteve financiare në shtetin e origjinës, prandaj konsiderohet se mërgata është një faktor i rëndësishëm në zhvillimin e vendeve të origjinës dhe kjo duhet marrë parasysh në Projektligj.

## *Raporti Ligj-akte nënligjore*

Në diskutimin e tij **Heset Cakolli** u shpreh se Projektligji për Mërgatën e Kosovës është shumë i nevojshëm, sepse krijon një kornizë

Ky projektligj është i hartuar vetëm me 17 nene, ndërsa ato nuk i sqarojnë shumë çështje me rëndësi. Për shembull, në nenin 6 pika 1.1. thuhet: “Agjencia e Mërgatës zbaton dhe monitoron dispozitat e këtij ligji dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij”. Shtrohet pyetja, sa do të jetë numri i atyre akteve nënligjore, kur kemi parasysh numrin kaq të vogël të neneve të këtij projektligji, shtroi pyetjen deputeti Cakolli.

**Mark Krasniqi** shfaqti mendimin se detyra e organizimit dhe e zbatimit të ndihmës mërgimtarëve duhet të jetë në kompetencën e ambasadave dhe të konsullatave të Republikës së Kosovës e jo të asnjë ministrie tjetër në Kosovë. Kështu, mërgimtarët do të jenë në kontakt të përhershëm me këto institucione të rëndësishme shtetërore.

Ministria është shumë larg dhe çdo punë e saj në këtë drejtim do të jetë më e vështirë dhe më e komplikuar.

Ambasada ose konsullata do të kryente çdo punë të tillë shumë më shpejt e shumë më lehtë, madje edhe me më pak mjete financiare. Ndërkaq, me nenin 3 të Projektligjit për mërgimtarët duhet të thuhet qartas se ata janë shtetas të Republikës së Kosovës, me status – punëtorë të përkohshëm në botën e jashtme, ku janë me qëndrim të përkohshëm ose të përhershëm.

Shteti kujdeset për shtetasit e vet e jo për ata që kanë “prejardhje familjare nga Republika e Kosovës”, siç thuhet në projektligj. **Emrush Xhemajli** tha se në këtë projektligj duhet të përfshihen të gjitha kategoritë e shqiptarëve që kanë kontribuar në forma të

dhe koordinojë punët me vendet e rajonit me interesa të përbashkëta, duke bërë shpërndarjen e librave shkollorë për mësimin dhe avancimin e gjuhëve zyrtare, duke shpërndarë libra letrarë, shkencorë dhe ato të trashëgimisë kulturore dhe duke organizuar seminare trajnuese për mësimdhënësit. Në nenin 9 të Projektligjit përcaktohen përgjegjësitë e qendrave kulturore për Kosovën, ku ndër të tjera Qeveria e Kosovës me plane kulturore nxit investimet kapitale në vendlindje. Por, çka i duhet nenit 9, pika 1.8, po e citoj: “Qendrat kulturore të Kosovës për mërgatën kryejnë detyrat tjera të përcaktuara nga Kryeministri”, kur dihet që mekanizëm për zbatimin e këtij projektligji është Agjencia e Mërgatës, e udhëhequr nga kryeshefi ekzekutiv i Agjencisë së Mërgatës, i cili në bashkëpunim i bashkërendit

### ***Përqindja e mërgatës në skemën programore të televizionit publik***

**Armend Zemaj** shtroi çështjen se, nëse vendoset me ligj që Televizioni Publik i Republikës së Kosovës të obligohet që përafërsisht, qysh shkruhet në Projektligj, 5 deri 7 për qind e skemës programore të ofrojë program për mërgatën, atëherë si do të jetë procesi i monitorimit për të parë se apo i përmbahet kësaj përqindjeje televizioni publik. Në vijim ai tha se në ligje, në të gjitha rastet kur përmendet Kosova, duhet të shkruhet Republika e Kosovës.

### ***Variacionet e titullit të Projektligjit***

Në fjalën e tij **Sabri Hamiti** u përqendrua në variacionet e titullit të Projektligjit. Përkitazi me këtë ai tha: “Nëse, si thonë latinët, emri është sendi, atëherë ajo që ka brenda, duhet të ishte edhe në titull. Problemi është në variacionet e titullit. Shqip thotë “Ligji për Mërgatën”, anglisht është “për diasporën”, edhe serbokroatisht ose serbisht është “për diasporën”. Çështja është që nuk janë terma të barasvlershëm – diaspora dhe mërgata”. Duke u ndërlidhur me këtë problematikë, **Hydajet Hyseni-Kaloshi** pohoi se pajtohet që titulli nuk është sa duhet adekuat. “Edhe për mua qëndron ai dallimi diasporë – mërgatë. Do të ishte mirë që të jetë edhe njëra edhe tjetra, se objektivisht në rastin tonë janë të dyja. Kemi diasporë, por ka edhe mërgatë, që s’mund të futet lehtë në kallëpet e diasporës”.

**Arsim Rexhepi** ishte i mendimit se ky projektligj tregon se është sjellë me panik dhe nguti dhe nuk ka konsulencën as më të përafërt të ndonjë eksperti, i cili sadopak do të mund të kishte njohuri, dije dhe përvojë jetësore se çka, si dhe ç’përjeton, ç’është dhe ç’mund të jetë diaspora apo mërgata e Kosovës.

Ky projektligj, i sjellë kështu me nguti dhe pa fijen e ekspertizës, nuk pretendon dhe nuk zgjon asociacion tjetër përveç tendencës së Qeverisë, të Kryeministrit për të marrë ingerenca të zhvillimit të politikave me atë pjesë të popullit të Kosovës, që po e quajmë mërgatë ose diasporë. Është një tendencë e pa llogaritur mirë, e cila nuk ia vlen të përkrahet dhe nuk duhet të përshëndetet, theksoi ai.

**Fatmir Rexhepi** tha se ajo që del këtu në sipërfaqe dhe që ka rëndësi të debatohet edhe nga komisionet parlamentare gjatë debatit të mëturshëm, është roli i Agjencisë. Në vijim ai shprehu mendimin se nuk ka nevojë për Agjenci. Do të ishte më mirë që, qoftë në kuadër të Ministrisë së Punëve të Jashtme, apo në qoftë se Qeveria e ka vlerësuar se duhet të themelohet Ministria e Integritimit, atëherë të bëhet Ministria e Integritimit dhe e Mërgatës, për arsye se këtu mund të kodifikohet dhe të rregullohet më lehtë funksionimi i një trekëndëshi në mes të Ministrisë dhe Qeverisë, ambasadave apo konsullatave dhe mërgatës.

*Shefqet Rexhepi*



ndryshme në diasporë, që të kenë lehtësira dhe favore të merituar në Kosovë.

### ***Synohet promovimi i vlerave të mërgatës***

**Sanije Aliaj** theksoi se me këtë projektligj rregullohen përgjegjësitë dhe kompetencat e Agjencisë së Mërgatës, e cila nën udhëheqjen e kryeshefit të Agjencisë synon të zbatojë politikën për promovimin e vlerave të mërgatës, koordinon punën me qendrat kulturore të mërgatës, rregullon bashkëpunimin në mes institucioneve dhe shoqërisë civile për përmirësimin e pozitës së mërgatës. Qeveria e Republikës së Kosovës nëpërmjet Agjencisë së Mërgatës dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Ministrinë e Kulturës në lëmin e realizimit të procesit mësimor do të bashkërenditë

veprimet me Qendrën Kulturore të Kosovës për funksionalizimin e mërgatës. Ky paragraf mund të mbetet në kuadër të projektligjit vetëm nëse definohen detyrat që duhet t’i zbatojë Qendra Kulturore e Mërgatës, sepse për ndryshe do të vihej në pikëpyetje demokracia për funksionalizimin e mërgatës, theksoi deputetja Aliaj. Ajo në vijim propozoi që të themelohet Ministria e Mërgatës.

Një propozim të këtillë e përkrahu edhe deputeti **Ibrahim Makolli**, i cili tha se krijimi i kësaj ministrie do të mundësonte ndërmarrjen e veprimeve për t’iu dalë në ndihmë mërgimtarëve tanë. Ngritjen e kësaj ministrie e kërkoi në diskutimin e tij edhe deputeti **Riza Smaka**.

# Kryeparlamentari Krasniqi priti: Sekretarin e Shtetit në Ministrinë Federale të Mbrojtjes të Republikës Federale të Gjermanisë, Kossendey

**Gjermania premtion bashkëpunim të ngushtë ndërmjet parlamenteve të dy vendeve dhe ndihmë për Kosovën edhe në të ardhmen  
Është biseduar për strategjinë për veriun, si një dokument i rëndësishëm për shtrirjen e rendit dhe ligjit edhe në atë pjesë të Kosovës**

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, dr. Jakup Krasniqi, priti sot në një takim sekretarin e shtetit në Ministrinë Federale të Mbrojtjes të Republikës Federale të Gjermanisë, Thomas Kossendey, i cili ishte i shoqëruar nga gjashtë anëtarë të Bundestagut gjerman, si dhe ambasadori i Gjermanisë në Prishtinë, Hans-Dieter Steinbach dhe gjenerali i KFOR-it Markus Bentler, ku u bisedua për zhvillime aktuale në Kosovë.

Kryeparlamentari Krasniqi në prononcimin e tij para mediave, tha se në këtë takim u bisedua edhe për strategjinë për veriun, si një dokument i rëndësishëm i Qeverisë së Kosovës dhe i Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar, për shtrirjen e rendit dhe ligjit edhe në atë pjesë të Kosovës.

Krasniqi tha se e ka njoftuar delegacionin gjerman me punën dhe angazhimet e Kuvendit të Kosovës në miratimin e ligjeve, sidomos të atyre që kanë dalë nga Pakoja e Ahtisaarit. Kreu i Kuvendit tha se e ka ngritur edhe çështjen e liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës, ndërkaq ka folur edhe për pengesat dhe vështirësitë me të cilat përballlet Kosova në aspektin e zhvillimit ekonomik, veçanërisht në sferën e punësimit. “Ne si parlament kemi punuar dhe kemi bërë një infrastrukturë ligjore që garanton investime dhe zhvillim ekonomik në Kosovë”, theksoi kryeparlamentari Krasniqi, duke e falënderuar zyrtarin e lartë të shtetit gjerman për të gjithë mbështetjen politike, ekonomike dhe në sferën e sigurisë, që

Gjermania ka dhënë për Kosovën gjatë gjithë këtyre viteve.

Sekretari i shtetit në Ministrinë Federale të Mbrojtjes të Republikës Federale të Gjermanisë, Thomas Kossendey, tha se ndihma gjermane për Kosovën ka qenë e arsyeshme, dhe se Kosova ka bërë bërë mrekullira.

Duke premtuar bashkëpunim të ngushtë ndërmjet parlamenteve të dy vendeve, Kossendey konfirmoi ndihmën e shtetit të tij për Kosovën edhe në të ardhmen. Ai tha se institucionet e Kosovës, përmes Forcës së Sigurisë dhe Policisë, kanë krijuar edhe kushtet që të marrin sa më tepër përgjegjësi në duart e tyre, duke treguar për përparimet që janë bërë ndërkohë. Z. Kossendey tha se nëse kjo kontribuon që Gjermania dalëngadalë të reduktojë numrin e ushtarëve të saj në Kosovë, nuk do të thotë që përfundon bashkëpunimi me Kosovën. “Ne do ta krijojmë një tejkallim konstruktiv të përgjegjësive të sigurisë nga forcat tona në tuajat. Kështu që në këtë mënyrë të krijojmë një rrugë tjetër të bashkëpunimit ndërmjet nesh. Dhe vërtet kam një respekt të madh se me çfarë serioziteti i merrni sugjerimet nga raporti zhvillimor i BE-së, dhe çfarë mësimi merrni nga ky raport”, theksoi Thomas Kossendey.

Ai foli edhe për bisedimet rreth riatdhesimit të qytetarëve të Kosovës, duke vlerësuar se ky është një parakusht kryesor që do të përcaktojë rrugën e mëtejshme të liberalizimit të vizave.

## Ministrin e Mbrojtjes të Shqipërisë, Arben Imami

### Anëtarësimi i Shqipërisë në NATO e përshpejton edhe anëtarësimin e Kosovës në strukturat euro-atlantike

**Kuvendi dhe institucionet e tjera të Kosovës i kanë dhënë mbështetje të fuqishme FSK-së për modernizim dhe përmbushjen e misionit të saj kushtetues  
FSK-ja prodhon siguri, jo vetëm për Kosovën, por për gjithë rajonin**

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, dr. Jakup Krasniqi, ka pritur sot ministrin e Mbrojtjes së Shqipërisë, Arben Imami, me të cilin ka biseduar për thellimin e bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve, në funksion të sigurisë së qytetarëve dhe të paqes e të qëndrueshmërisë në rajon.

Duke i dëshiruar z. Imami mirëseardhjenë Kuvendin e Republikës së Kosovës, kryeparlamentari Krasniqi ka falënderuar shtetin shqiptar për mbështetjen e gjithanshme për Kosovën, duke theksuar se të dy vendet tona duhet të bëjnë edhe më shumë për bashkëpunim me interes të ndërsjellë. “Anëtarësimi i Shqipërisë në NATO e përshpejton edhe anëtarësimin e Kosovës në strukturat euro-atlantike”, ka theksuar



Krasniqi, i cili ka vënë në pah se Kuvendi dhe institucionet e tjera të Kosovës i kanë dhënë mbështetje të fuqishme FSK-së për modernizim dhe përmbushjen e misionit të saj kushtetues për vendin. Ai ka folur edhe për punën e madhe të Kuvendit të Kosovës, sa i përket sigurimit të kushteve të barabarta për zhvillim të suksesshëm të të gjitha komuniteteve në Kosovë, duke pohuar se pas zgjedhjeve të fundit lokale është shtuar

interesimi i qytetarëve nga komuniteti serb për integrim në shoqërinë e Kosovës.

Kreu i Kuvendit e ka uruar ministrin Imami për përballimin e situatës së vështirë në pjesën veriore të Shqipërisë pas përmblyetjeve

të shkaktuara në fillim të këtij viti.

Ministri i Mbrojtjes i Shqipërisë, Arben Imami, duke e përgëzuar kryeparlamentarin Krasniqi për të arriturat impesive të Kosovës, e ka uruar atë për dyvjetorin e Pavarësisë së vendit. Ai i ka përcjellë z. Karsniqi, institucioneve të vendit dhe popullit të Kosovës, falënderimet e kryeministrit Berisha për mbështetjen e gjerë dhe të pakursyer për zonat e përmbytura të Shqipërisë.

Imami ka shprehur kënaqësinë e tij për të arriturat e deritashme të FSK-së, si dhe ka shprehur vullnetin e ministrisë, të cilën e udhëheq, për të mbështetur në vazhdimësi jo vetëm FSK-në, por edhe të gjithë strukturat e tjera që janë të lidhura me sigurinë e Kosovës. FSK-ja prodhon siguri, jo vetëm për Kosovën, por për gjithë rajonin, ka theksuar Imami.

## Kongresistin amerikan, Eari Pomeroy

### Mirënjohje për ndihmën e gjithanshme që po u japin SHBA-të proceseve të gjithëmbarshme të Kosovës

**Në Kosovë është shënuar progres i jashtëzakonshëm, por para saj shtrohen edhe sfida. Gatishmëri e dyanshme për thellim të bashkëpunimit e partneritetit**



Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, dr. Jakup Krasniqi, kishte sot një takim me kongresistin amerikan, Eari Pomeroy, i cili shoqërohej edhe nga ambasadori Kristofer Dell. Duke i uruar mirëseardhje kongresistin Pomeroy, kryekuvendari Krasniqi, falënderoi atë për pjesëmarrje në seancën e nesërme solemne të Kuvendit të Kosovës. Në vijim kryekuvendari Krasniqi e njoftoi kongresistin amerikan për të arriturat në Kosovë, proceset e ndërtimit të shtetit demokratik, paqësor e multietnik, strukturën e Kuvendit, për ligjet e miratuara që dolën nga Pakoja Gjithëpërfshirëse e Ahtisaarit, si dhe për ecuritë e njohjeve të pavarësisë së Kosovës, anëtarësimin në Fondin Monetar Ndërkombëtar, në Bankën Botërore, si dhe synimin për anëtarësim në OKB. Mysafiri amerikan

u njoh edhe me procesin e mbrojtjes së pavarësisë së Kosovës në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë. Z. Krasniqi i kushtoi vëmendje edhe zhvillimit ekonomik të Kosovës, duke theksuar se në vitin 2009, rritja ekonomike shënoi një rritje 4 për qind. Pastaj kryekuvendari Krasniqi foli edhe për aspekte të decentralizimit, të integritetit të komuniteteve, zgjedhjet e suksesshme - të parat pas pavarësisë, si dhe për strategjinë e veriut, si dhe disa vështirësi me të cilat ballafaqohet Kosova në zhvillimin e saj të gjithëmbarshtëm. Në të gjitha këto procese, theksoi kryekuvendari Krasniqi, Kosova ka gëzuar një ndihmë të madhe dhe të gjithanshme nga ana e SHBA-së, ndaj ai në këtë frymë shprehu falënderim për SHBA-të, Kongresin Amerikan, forcat e SHBA-së në kuadër të KFOR-it, si dhe ndihmën e madhe që i jep vendit tonë edhe Ambasada e SHBA-së dhe ambasadori i saj Dell.

Në vijim të këtij takimi morën pjesë anëtarët e Kryesisë së Kuvendit të Kosovës. Kongresisti amerikan, Eari Pomeroy, shprehu kënaqësi për këtë takim të përbashkët dhe për rastin që iu dha për t'ua uruar Ditën e Pavarësisë së Kosovës kryekuvendarit dhe anëtarëve të Kryesisë, duke i përgëzuar edhe për rezultatet e arritura. Në këtë frymë ai përcolli edhe përkrahjen e fuqishme të legjislativit amerikan për Kosovën. "Në Kosovë është shënuar progres i jashtëzakonshëm, por para saj shtrohen edhe më tutje sfida", theksoi ai. Është e rëndësishme, theksoi ai, që po funksionon sundimi i ligjit, si në gjykata ashtu edhe në legjislativ. Në vijim ai tha se në SHBA që 20 vjet vepron një komision që ka partneritet me demokracitë e reja në botë. Në këtë kuadër ky komision do të ketë partneritet edhe me Kosovën, madje në këtë vështrim tashmë janë bërë edhe disa takime. Një aspekt i angazhimit do të jetë edhe ndihma ndaj stafit të Kuvendit, sepse ligjvënësit janë të mirë kur e kanë të mirë edhe stafin. Duke përgëzuar Kryesinë për punën e saj, kongresisti Eari Pomeroy përshëndeti posaçërisht anëtarin e Kryesisë së Kuvendit, Slobodan Petroviqin, më të cilin kishte pasur një takim në Uashington, duke ftuar edhe anëtarët tjerë të Kryesisë që të bëjnë vizita të këtilla. Slobodan Petroviqi shprehu kënaqësinë që takohen sërish me kongresistin Pomeroy. Ai tha se përvojën e fituar në SHBA e ka ndarë edhe me kolegët e tij në Kryesi. Kongresisti amerikan shprehu gatishmërinë për thellim të bashkëpunimit e partneritetit. Në këtë vështrim, Eari Pomeroy shprehu kënaqësinë që Pakoja Gjithëpërfshirëse e Ahtisaarit po zbatohet edhe në fushën e sigurimit të të drejtave të minoriteteve.

Në diskutimin e tij anëtari i Kryesisë, Sabri Hamiti shprehu kënaqësinë për këtë takim në prag të përvjetorit të Pavarësisë së Kosovës, duke theksuar se tashmë: "Jemi mësuar të jemi afër në gëzime dhe në vështirësi".

## Komunitetet

Sektori federal i punëve të jashtme i Zvicrës dhe Qendra evropiane për çështje të pakicave e Kosovës për anëtarët e Komisionit për të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe për kthim organizuan punëtorinë me temën: “Praktika e mirë parlamentare”

# Në punën e Parlamentit të Kosovës dhe Zvicrës ka shumë ngjashmëri

Do të duhej që në Kuvendin e Kosovës më shumë t'i kushtohet kujdes propozimeve që vijnë nga anëtarët e Komisionit, që janë përfaqësues të komuniteteve pakicë, në mënyrë që propozime e tyre të mos mbivotohen ose mos të aprovohen çdoherë nga mazhoranca, pastaj që këshillat me rastin e mos zbatimit të ligjeve në terren të kenë më shumë ingjerenca dhe të mos ketë pengesa lidhur me përkthimin në gjuhët e komuniteteve. Në Parlamentin e Zvicrës, me rastin e miratimit të një ligji të ri anëtarët e Komisionit kërkojnë shërbime nga ekspertë apo ekipe ekspertësh dhe në shumicën e rasteve kërkojnë edhe mendimin e anëtarëve të organizatave joqeveritare dhe të shoqërisë civile si dhe të vetë qytetarëve.



Sektori federal i punëve të jashtme i Zvicrës (SFPJZ) dhe Qendra evropiane për çështje të pakicave e Kosovës (QEÇPK) sot, në vilën “Gërmia”, për anëtarët e Komisionit për të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe për kthim organizuan punëtorinë me temën: “Praktika e mirë parlamentare”.

Në punëtorinë e përmendur, përveç anëtarëve të Komisionit për të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe për kthim morën pjesë edhe anëtarët e Këshillit konsultativ të komuniteteve të Kosovës, përfaqësues nga OSBE-ja disa anëtarë të organizatave joqeveritare dhe të shoqërisë civile të Kosovës, kurse në cilësinë e mysafirit special ishte i pranishëm edhe ambasadori i Zvicrës në Prishtinë, z. Lukas Beglinger. Gjatë punëtorisë një ditore dhe në kuadër të

projektit të gjerë me qëllim të mbështetjes së integritit të problemeve të komuniteteve në punën e Qeverisë kosovare dhe të Parlamentit, këtë punëtori e moderuan dhe e udhëhoqën këshilltari për paqe i Sektorit federal për punë të jashtme të Zvicrës, z. Armin Rieser si dhe drejtori qendres evropiane për çështje të pakicave të Kosovës, g. Adrijan Zeqiri.

Në kuadër të këmbimit të përvojave të një komisioni të Parlamentit zviceran, gjatë punëtorisë së përmendur u shfaq një film dokumentar me titull “ Misri në parlament”. Anëtarët e Komisionit për të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe kthim si dhe të gjithë pjesëmarrësit tjerë nëpërmes të këtij filmi mësuam sesi funksionon procedura e mendimit dhe e miratimit të një projektligji që nga fillimi kur ligji dërgohet nga ana e

sponsoruesit, përkatësisht nga Qeveria e Zvicrës, pastaj nga dhënia e amendamenteve nga ana e anëtarëve të Komisionit, përfshirja e ekspertëve të ndryshëm nga fusha me të cilën ka të bëjë projektligji përkatës, mendimi dhe reagimi i shoqërisë civile dhe i organizatave joqeveritare si dhe në fund lufta për vota brenda Komisionit nga ana e grupeve të ndryshme politike për miratimin e amendamenteve të tyre dhe për dërgimin e ligjit në shqyrtimin e parë në Parlamentin e Zvicrës.

Pas shikimit të filmit të përmendur dokumentar u zhvillua diskutim gjithëpërfshirës dhe të pranishmit theksuan se filmi dokumentar paraqet një bazë të mirë për t’u parë se cilat janë dallimet dhe ngjashmëritë e punës së të dy parlamenteve kur është fjala për

procedimit dhe mendimit të një projektligji që nga fillimi, deri në fund. Gjatë diskutimit u tha se në punën e komisioneve, si atij të Parlamentit të Kosovës po ashtu edhe të Parlamentit të Zvicrës ka shumë ngjashmëri dhe, si atje po ashtu edhe këtu zhvillohet luftë e ashpër për miratimin e sa më shumë amendamenteve të një apo grupi tjetër politik. Njëkohësisht ka ngjashmëri midis dy parlamenteve kur opozita zhvillon luftë të ashpër që amendamentet e tyre të kuptohen në mënyrë të drejtë dhe të përkrahen, në mënyrë që amendamentet e tyre në fund të lejohen dhe të miratohen nga ana e anëtarëve të koalicionit udhëheqës.

Në punëtorinë e përmendur u tha se do të duhej që në Kuvendin e Kosovës më shumë t'i kushtohet kujdes propozimeve që vijnë nga anëtarëve të Komisionit, në mënyrë që propozime e tyre të mos mbivotohen ose mos të aprovohen çdoherë nga mazhoranca, që të mos ndodh, siç ka ndodhë deri tash në shumicën e rasteve, që projektligjet të kopjohen nga ligjet e vendeve të tjera nga regjioni dhe më gjerë, por, duke marrë parasysh specifikat e Kosovës ligjet të përputhen me këto specifika, që ministrat të t'u përgjigjen ftesave kur ata ftohen nga komisionet e Kuvendit, që komisionet të kenë injerencën më të mëdha kur është fjala për zbatimin e ligjeve në terren, të mos ketë pengesa lidhur me përkthimin në gjuhët e komuniteteve etj.

Ambasadori i Zvicrës në Prishtinë, z. Lukas Beglinger e mori fjalën në vazhdim të punës së punëtorisë dhe, midis të tjerash, tha se ky film dokumentar së paku ka treguar se cilat janë ngjashmëritë dhe ndryshimet në punën e komisionit, si të atij të Parlamentit zviceran, po ashtu edhe të Parlamentit të Kosovës. Ai theksoi se në Zvicër ekzistojnë dy këshilla – Këshilli Kombëtar ose Kuvendi dhe Këshilli i Kantoneve, ku 26 kantone i kanë përfaqësuesit e vet. Për shkak të kantonizimit, Parlamenti Zviceran në punën e tij dallon nga Parlamenti i Kosovës por, në esencë, të dy parlamentet në shumicën e rasteve kryejnë punë të njëjta legjislative. Ambasadori në vazhdim theksoi se në Parlamentin zviceran gjuhët gjermane, frënge dhe italiane janë gjuhë zyrtare, kurse në punën e Parlamentit përdoret edhe gjuha rome. Kështu, sa i përket përkthimit me gojë dhe me shkrim nuk ka problem dhe çdo kush e përdorë gjuhën e vet amtare. Z. Beglinger në fund theksoi se kur në Parlamentin zviceran miratohet ndonjë ligj i ri, anëtarët e Komisionit kërkojnë ndihmë nga ekspert apo ekupe të tëra ekspertësh dhe në shumicën e rasteve kërkohet edhe mendimi i anëtarëve të organizatave joqeveritare dh i shoqërisë civile si dhe i vetë qytetarëve.

Në fund të punëtorisë u tha se edhe anëtarët e Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Bashkësive dhe për Kthim do të vizitojnë Parlamentin zvicerian në fillim të shkurtit ku aty për aty do të njihen me punën e gjithanshme të këtij Parlamenti.

*Celal Ilyias*

## Anëtari i kryesisë së Kuvendit të Kosovës Slobodan Petroviq, viziton Shqipërinë



Me ftesë të Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Ilir Meta, të Republikës së Shqipërisë, anëtari i Kryesisë së Kuvendit të Kosovës Slobodan Petroviq bëri një vizitë të shkurtër miqësorë në Shqipëri.

Ai u takua me kryeparlamentaren e Kuvendit znj. Jozefina Topalli dhe Zëvendëskryeministrin e Ministër i Jashtëm i Republikës së Shqipërisë z. Ilir Meta.

Jemi pritur shumë mirë dhe ajo çfarë ka bërë përshtypje tek ky takim, është, se ne kemi dërguar një mesazh të fuqishëm në interes të të gjithë qytetarëve që jetojnë këtu. Për sa u përket nikoqirëve tanë, vizita është vlerësuar si një vizitë me të vërtetë historike. Mikpritësit tanë kanë shfaqur interesim dhe janë interesuar për pozitën e komunitetit serb në Kosovë, e posaçërisht, përndërtimin dhe funksionimin e komunave të reja, ku në shumicë jetojnë serbët.

Në kuadër të kësaj vizite, me institucionet më të larta shqiptare kemi kontraktuar një ndihmë ekonomike për komunën e Graçanicës, një shumë prej 400.000 euro. Ajo, çka është shumë e rëndësishme, është, se ky është vetëm fillimi i një bashkëpunimi për ndihmë të mëtejme, të cilat konsiderohen vetëm si ura të bashkëpunimit dhe mirëkuptimit midis popujve me kombësi ndryshe.

Midis të tjerash, kryeparlamentarja e Kuvendit të Shqipërisë Jozefina Topalli, vlerësoi dhe theksoi me kënaqësi pjesëmarrjen e një numri të madh në zgjedhjet e fundit lokale, të popullsisë serbe.

Në kuadër të kësaj vizite, ne gjithashtu kemi kryer edhe një vizitë në qytetin e Durrësit. Pas takimit me kryetarin e bashkisë së Durrësit, vizituam kishën ortodokse të këtij qyteti.

## Kryeparlamentari Krasniqi priti:

### Sekretarin e shtetit të Hungarisë, Jeno Faler

Kryetari i Kuvendi të Kosovës, dr. Jakup Krasniqi, e ka pritur sekretarin e shtetit dhe zëvendësministrin e Punëve të Jashtme të Hungarisë, Jeno Faler, me të cilin ka biseduar për thellimin e bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve mike. Duke e falënderuar mikun për fjalët e mira, e ka njoftuar atë se në fillim të vitit 2010, do ta vizitojë Budapestin, me ç'rast do të nënshkruaj edhe një marrëveshje për bashkëpunim ndërmjet dy parlamenteve.

### Eurodeputeten Ernest

Kryetari i Kuvendi të Kosovës, dr. Jakup Krasniqi, priti deputeten e Parlamentit Evropian, znj. Cornelia Ernest, me të cilën ka biseduar për kushtet e jetesës së pjesëtarëve të komuniteteve, e në mënyrë të veçantë të pjesëtarëve të komunitetit rom ashkalinj dhe egjiptian. Eurodeputetja Ernest ka bërë të qartë se qëllimi i vizitës së saj në Kosovës është pikërisht mbledhje a informacionit për kushtet e jetesë dhe për integrimin e qytetarëve me përkatësi etnike rome. ashkalinje dhe egjiptiane të cilët pritet të kthehen nga Gjermania. Kryeparlamentari Krasniqi ka përmendur ndërtimin e qendrave të përkohshme të banimit, në të cilat jetojnë 925 familje të këtyre komuniteteve, me mbi katër mijë banorë, duke theksuar se qendra të tilla vazhdojnë të ndërtohen në disa komuna (Skenderaj, Mitrovicë, Deçan), kurse janë duke u financuar edhe projekte për rindërtim dhe ndërtim të shtëpive private.

### Presidentin e Sllovenisë, Danilo Turk

Duke i uruar mirëseardhjen në Kosovë presidentit slloven, Kryetari i Kuvendit Dr. Jakup Krasniqi e ka falënderuar për mbështetjen e gjithanshme të Republikës së Sllovenisë dhe të z. Turk, personalisht, për Kosovën dhe të ardhmen e saj drejt integriteteve evropiane. Presidenti i Republikës së Sllovenisë, dr. Danilo Turk, ka vlerësuar zhvillimet e pandërprera demokratike, tregues i të cilave janë edhe zgjedhjet e sapo mbajtura lokale në Kosovë. Ai ka theksuar vendosmërinë e vendit të tij për të thelluar bashkëpunimin ndërmjet dy vendeve, se ka hapësira të gjëra për thellim të bashkëpunimit ndërparlamentar, në lëmin e ekonomisë, të investimeve etj. Ndërkaq, ka premtuar mbështetjen e Sllovenisë për forcim të ekonomisë së Kosovës dhe për anëtarësim në strukturat evropiane.

### Aambasadorin e Arabisë Saudite në Tiranë, Abdullah Abdulaziz Al-Abdulkarim

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, dr. Jakup Krasniqi, priti sot në një takim ambasadorin e Mbretërisë së Arabisë Saudite në Tiranë, jorezident në Prishtinë, Abdullah Abdulaziz Al-Abdulkarim, me të cilin bisedoi rreth bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve. Pasi e falënderoi Mbretërinë e Arabisë Saudite dhe popullin e saj për njohjen e Republikës së Kosovës, Krasniqi bëri një përshkrim të vuajtjeve të popullit të Kosovës nën pushtetin serb, për 90 vjet rresht, duke theksuar se pavarësia është hapi më madhështor në historinë e Kosovës. Pavarësia ka krijuar paqe dhe stabilitet jo vetëm në Kosovë, por ka reflektuar në të gjithë rajonin e Ballkanit. Ambasadori Abdullah Abdulaziz Al-Abdulkarim, falënderoi për pritjen dhe ndjenjat e sinqerta që iu shprehën atij. Ndihej shumë krenar që jam ambasadori i parë i Mbretërisë së Arabisë Saudite në Republikën e Kosovës. Në Kosovë gjeta një dimër të ftohtë, por nuk e ndjeva atë për shkak të ngrohtësisë që mu rezervua. Njohja e Republikës së Kosovës nga e shteti i tij, është tregues i respektit të madh që populli i Mbretërisë së Arabisë Saudite ka për popullin e Kosovës. Ai tha se vendi i tij nuk do të kursej asgjë për të forcuar marrëdhëniet ndërmjet dy shteteve sovraane, dhe për të mbështetur Kosovën në të gjitha institucionet ndërkombëtare.

## Takim i Komisionit për Buxhet me përfaqësues të Fondit Monetare Ndërkombëtar

### Nismë për hartimin e Ligjit të ri mbi bankat në Kosovë

Komisioni për Buxhet dhe Financa i Kuvendit të Kosovës, i kryesuar nga Gani Koci, kishte sot një takim me përfaqësuesin e Fondit Monetar Ndërkombëtar, Åke Lönnberg, i cili shoqërohej edhe nga eksperti José Benjamín Escobar. Në këtë takim u bisedua gjerësisht për nismën e ndërmarrë për hartimin e Ligjit për Bankat, pasi deri tash Kosova kishte një Rregullore të vitit 1999, të hartuar nga UNMIK-u, e cila në kontekstin e ri të zhvillimeve financiare në Kosovë është tejkaluar. Si në fjalën hyrëse të kryetarit të Komisionit, Gani Koci, ashtu edhe në diskutimet e anëtarëve të Komisionit, u vlerësua se është e mirëseardhur nisma për hartimin e Ligjit mbi bankat, pasi në fushën financiare në Kosovë hetohen zbrastësi ligjore, meqë Rregullorja e përmendur nuk përmbush ato.

Përkitazi me këtë u tha se gjithnjë është kërkuar që të plotësohet kuadri ligjor në fushën financiare, duke ditur se janë të pranishme disa parregullsi në veprimtarinë e bankave, siç janë kamatat, kriteret e licencimit, konflikti i interesit etj. U tha, po kështu, se ndihet nevoja edhe për plotësimin e ndryshimin e Ligjit mbi Bankën Qendrore të Kosovës, punë kjo që do të ishte mirë të bëhej para se ta aprovohej Ligji mbi bankat.

Z. Åke Lönnberg bëri një prezantim të gjerë të aktiviteteve që do të zhvillohen përkitazi me punët përgatitore dhe rreth fillimit të hartimit të Ligjit mbi bankat, duke përshkruar edhe fazat e përgatitjeve teknike të këtij Projektligji. Ai u angazhua për një ligj të standardeve më të larta ndërkombëtare në fushën financiare, pasi edhe rrethanat tashmë kanë ndryshuar nga koha kur është sjellë Rregullorja mbi bankat e UNMIK-ut.

Sipas, z. Lönnberg pos këtij kriteri që duhet të përmbushë Ligji i ri mbi bankat, ai duhet të përmbajë edhe kodet dhe standardet ndërkombëtare sa i përket licencës, mbikëqyrjes, pastaj të përmbajë edhe rregullat e Bazelit mbi veprimtarinë e bankave, kjo nuk do të thotë të gjitha, por në përpjekjet e Kosovës drejt integritetit evropian është e nevojshme që ky ligj të mbështetet edhe në këto rregulla.

Anëtarët e Komisionit shfaqën gatishmëri për të bashkëpunuar në të gjitha fazat e procesit të hartimit të këtij Projektligji, të vetëdijshëm se ai do të jetë një bazë e mirë për funksionimin e bankave, të liberalizimit të tregut financiar në Kosovë, e duke mënjeluar monopolet dhe parregullsitë tjera në fushën financiare.

Sipas dinamikës së përshkruar gjatë këtij takimi doli vlerësimi se ky Projektligj do të duhej të përfundojë të gjitha fazat, nëpër të cilat kalon një projektligj deri në fund të vitit të ardhshëm, në mënyrë që Ligji mbi bankat të aprovohet dhe të fillojë të zbatohet nga fillimi i 2011.



## Definimi sa më i saktë i statusit të shërbimit civil - në funksion të reformimit të administratës publike

Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media i Kuvendit të Kosovës, i kryesuar nga Esat Brajshori, kryetar i komisionit, mbajti sot një dëgjim publik përkitazi me Projektligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, në të cilin pos anëtarëve të Komisionit merrnin pjesë edhe mjaft përfaqësues të subjekteve të ndryshme vendëse e ndërkombëtare. Duke hapur këtë debat, Melihate Tërmkollli theksoi se me këtë Projektligj, i cili tashmë ka kaluar leximin e parë në Kuvendin e Kosovës, synojmë të bëjmë një ligj sistemor bazik.

Si në fjalën e Tërmkollit, ashtu edhe të diskutuesve të tjerë, u tha se një ndër qëllimet parësore gjatë diskutimit dhe amendamentimit të këtij Projektligji duhet të jetë definimi sa më i saktë i statusit të shërbimit civil, përkatësisht shërbyesit civil, parakusht ky i rëndësishëm në funksion të reformimit të administratës publike dhe ngritjes së cilësisë së këtij shërbimi.

Duke përshkruar rrugën e hartimit të këtij Projektligji, në emër të Zyrës Ligjore të Kryeministrit, Besim Kajtazi tha se hartimit të këtij Projektligji i ka paraprirë një periudhë e gjatë e konsultimit të shumë faktorëve gjer në finalizimin e këtij projekti. Tërë ky proces, tha ai, ishte mjaft i hapur, duke pasur për bazë edhe strategjinë e administratës publike, si dhe përvojat e shteteve perëndimore. Gjatë hartimit të këtij Projektligji iu ka kushtuar kujdes edhe çështjes buxhetore, pra është synuar që krahas synimit për një administratë sa më efikase, të shpenzohen sa më pak mjete buxhetore. Në kuadër të vërejtjeve e plotësimeve që u dhanë gjatë debatit mjaft të gjerë, pos tjerash u tha se është e nevojshme të trajtohet më mirë çështja e Komisionit për Emërime të Larta, se dhe çështja e kalimit të punëtorëve nga kontrata me kohë të caktuar në kohë të përhershme, për të mos lënë hapësirë për voluntarizëm politik.

### *Pyetje pa përgjigje*

Qamile Morina Në Mitrovicë matanë lumit Ibër që pas lufte fëmijët e lagjes Kodra e minatorëve, e ndjekin shkollën në kontenerë edhe tash pas 10 vjetësh.

A e konsideroni si dështim të Ministrisë së Arsimit mos realizimin e këtij projekti vital për fëmijët e kësaj lagje të Mitrovicës. Nëse jo, çka keni ndërmarrë ju që të bëhet realitet shkolla fillore për këta fëmijë.

Qamile Morina Në Mitrovicë matanë lumit Ibër që pas lufte fëmijët e lagjes Kodra e minatorëve, e ndjekin shkollën në kontenerë edhe tash pas 10 vjetësh.

A e konsideroni si dështim të Ministrisë së Arsimit mos realizimin e këtij projekti vital për fëmijët e kësaj lagje të Mitrovicës. Nëse jo, çka keni ndërmarrë ju që të bëhet realitet shkolla fillore për këta fëmijë.

# STRATEGJIA LEGJISLATIVE PËR VITIN 2010

## Nr. Emri i Projektligjit Afati kohor për dërgim të projektligjit në Kuvend

### 1. ZYRA E KRYEMINISTRIT

- 1.1. Projektligji për të drejtat e njeriut 30.06.2010
- 1.2. Projektligji për nismat legislative 30.10.2010
- 1.3. Projektligji për personat e pagjetur 30.04.2010
- 1.4. Projektligji për parandalimin dhe luftimin e terrorizmit 31.05.2010
- 1.5. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për protokollin e shtetit të Republikës së Kosovës 30.06.2010
- 1.6. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003 / 12 për qasje në dokumente zyrtare 31.05.2010
- 1.7. Projektligji për verbërinë 30.09.2010
- 1.8. Projektligji për parandalimin dhe luftimin e trafikimit të kundër ligjshëm të materialeve nukleare dhe materialeve tjera radioaktive 15.12.2010
- 1.9. Projektligji për përgjimin e telekomunikimeve 01.12.2010
- 1.10. Projektligji për parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar 15.12.2010
- 1.11. Projektligji për hetimin e aksidenteve dhe incidenteve aeronautike 30.11.2010

### 2. MINISTRIA E EKONOMISË DHE FINANCAVE

- 2.1. Projektligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës në vitin 2011 30.11.2010
- 2.2. Projektligji për produktet e akcizës së duhanit në Kosovë 31.05.2010
- 2.3. Projektligji për ndalimin dhe kufizimin e importit të mallrave 30.06.2010
- 2.4. Projektligji për mallrat e liruar nga taksat doganore 31.05.2010
- 2.5. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-090 mbi Partneritet Publiko Private dhe koncesionet në infrastrukturë dhe procedurat për dhënie të tyre 30.09.2010
- 2.6. Projektligji për tregun e letrave me vlerë 31.08.2010
- 2.7. Projektligji për sigurimin e depozitave 31.03.2010
- 2.8. Projektligji për bankat 30.09.2010
- 2.9. Projektligji për Bankën Qendrore 31.07.2010
- 2.10. Projektligji për sigurimet 31.08.2010

2.11. Projektligji për transaksionet e pagesave 30.10.2010  
2.12. Projektligji për sigurimet e detyrueshme në trafik 15.12.2010  
2.13. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të Doganave dhe Akcizave 15.12.2010

2.14. Projektligji për Tatimin në Pronën e paluajtshme 31.03.2010  
2/12  
2.15. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-0112 për tatimin e Normës së Akcizës në Kosovë 28.02.2010  
2.16. Projektligji për Raportimet Financiare të Ndërmarrjeve 30.04.2010  
2.17. Projektligji për lojëra të fatit 30.04.2010  
2.18. Projektligji për pengimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit 31.03.2010  
2.19. Projektligji për Ndhmën Shtetërore 31.03.2010

### **3. MINISTRIA E DREJTËSISË**

3.1 Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Procedurën e Përmbarimit 15.12.2010  
3.2. Projektligji kundër rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve 31.05.2010  
3.3. Projektligji për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet penale dhe civile 31.05.2010  
3.4. Projektligji për ekstradim 30.09.2010  
3.5. Projektligji për transferimin e personave të dënuar 30.09.2010  
3.6. Projektligji për detyrimet 15.11.2010  
3.7. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Penal 30.11.2010  
3.8. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të Procedurës Penale 30.11.2010  
3.9. Projektligji për mbrojtjen e dëshmitarëve 30.04.2010  
3.10. Projektligji i drejtësisë për të Mitur 28.02.2010  
3.11. Projektligji për Avokatin e Popullit 28.02.2010  
3.12. Projektligji për Ndhmën Juridike Falas 30.11.2010  
3.13. Projektligji për Gjykatat 30.06.2010  
3.14. Projektligji për Prokuroritë Publike 30.06.2010  
3.15. Projektligji për Këshillin Gjyqësor 30.06.2010  
3.16. Projektligji për Këshillin Prokurorial 30.06.2010

### **4. MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**

4.1. Projektligji për gjendjen civile 31.07.2010  
4.2. Projektligji për riatdhesim 31.07.2010  
4.3. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për letërnjoftim 31.07.2010  
4.4. Projektligji për nënshkrimin elektronik 31.07.2010  
4.5. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për dokumentet e udhëtimit 31.07.2010  
4.6. Projektligji për dorëzimin vullnetar të armëve të zjarrit, municionit dhe materieve shpërthyesë

30.10.2010  
4.7. Projektligji për zjarrfikje dhe shpëtim 30.10.2010  
4.8. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Inspektoratin Policor të Kosovës. 30.04.2010  
4.9. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për përdorim civil të eksplozivëve 30.06.2010  
4.10. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen nga zjarri 30.06.2010  
4.11. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera 30.06.2010  
4.12. Projektligji për sigurinë private 31.03.2010  
4.13. Projektligji për pajisjen me armë të institucioneve të sigurisë 31.03.2010

### **5. MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR**

5.1. Projektligji për vlerësimin strategjik mjedisor 31.08.2010  
5.2. Projektligji për mbeturina 30.09.2010  
5.3. Projektligji për mbrojtjen e natyrës 30.06.2010  
5.4. Projektligji për ujërat e Kosovës 31.05.2010  
5.5. Projektligji për Qendrën historike të Prizrenit 30.06.2010  
3/12  
5.6. Projektligji për Hoqën e Madhe 30.06.2010  
5.7. Projektligji për parqet nacionale 31.08.2010  
5.8. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-024 për Vlerësimin e ndikimit në mjedis 30.04.2010  
5.9. Projektligji për fondin për mbrojtjen e mjedisit 31.05.2010  
5.10. Projektligji për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje 31.08.2010  
5.11. Projektligji për Ndërtimet 31.08.2010

### **6. MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE**

6.1. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shërbime sociale dhe familjare 15.06.2010  
6.2. Projektligji për Këshillin Ekonomiko Social 01.08.2010  
6.3. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Fondin Pensional të Kosovës 15.10.2010  
6.4. Projektligji i Punës 31.03.2010  
6.5. Projektligji për statusin dhe të drejtat e familjeve të dëshmorëve, invalidëve, veteranëve dhe pjesëtarëve të UÇK-së dhe familjeve të viktimave civile të luftës 31.05.2010  
6.6. Projektligji për sigurimin pensional dhe invalidor 01.12.2010  
6.7. Projektligji për greva 31.05.2010

### **7. MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTEVE**

7.1. Projektligji për sponsorizime dhe donacione 30.09.2010  
7.2. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për teatër 30.04.2010

- 7.3. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për sportin 30.09.2010
- 7.4. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për bibliotekat 31.08.2010
- 7.5. Projektligji për muzeun 31.03.2010
- 7.6. Projektligji për kinematografinë 30.11.2010

#### **8. MINISTERIA E ADMINISTRATËS PUBLIKE**

- 8.1. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Nr.03/L-134 për lirinë e asocimit në organizatat joqeveritare 30.10.2010
- 8.2. Projektligji për kadastër 30.11.2010
- 8.3. Projektligji për konfliktin administrativ 30.04.2010
- 8.4. Projektligji për organet qeveritare për shoqërinë e informacionit 31.03.2010
- 8.5. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2/L-28 për procedurën administrative 31.03.2010
- 8.6. Projektligji për statistikat zyrtare të Kosovës 31.03.2010
- 8.7. Projektligji për pagat e funksionarëve publikë 28.02.2010

#### **9. MINISTERIA E ENERGISË DHE MINIERAVE**

- 9.1. Projektligji për shërbimet sizmologjike 30.09.2010
- 9.2. Projektligji mbi efçencën e energjisë 30.04.2010

#### **10. MINISTERIA E FORCËS DHE SIGURISË SË KOSOVËS**

- 10.1. Projektligji për pensionet për shërbim në Forcën e Sigurisë së Kosovës 31.07.2010
- 10.2. Projektligji për rezervën aktive në Forcën e Sigurisë së Kosovës 30.04.2010

#### **11. MINISTERIA E TRANSPORTIT DHE POSTË TELEKOMUNIKACIONIT**

- 11.1. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për hekurdhat në Republikën e Kosovës 31.08.2010
- 11.2. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për telekomunikacionin 15.12.2010

#### **12. MINISTERIA E TREGTISË DHE INDUSTRIËS**

- 12.1. Projektligji për rezervat shtetërore të mallrave 31.08.2010
- 12.2. Projektligji për tregtinë me mallra strategjike 31.08.2010
- 12.3. Projektligji për Metrologji 31.03.2010
- 12.4. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L 123 për 30.04.2010 4/12 shoqëritë tregtare
- 12.5. Projektligji për mbrojtjen e konkurrencës 30.06.2010
- 12.6. Projektligji për marka tregtare 30.09.2010
- 12.7. Projektligji për dizajn industrial 30.09.2010
- 12.8. Projektligji për patenta 30.09.2010

#### **13. MINISTERIA E ARSIMIT SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISE**

- 13.1. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 2002/19 për

arsimin fillor dhe të mesëm në Kosovë

- 31.07.2010
- 13.2. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/42 Për veprimtarinë kërkimore –shkencore 15.12.2010
- 13.3. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 2003/14 për arsimin e lartë në Kosovë 31.08.2010

#### **14. MINISTERIA E ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL**

- 14.1. Projektligji për emërtimin e komunave dhe fshatrave 15.12.2010
- 14.2. Projektligji për bashkëpunimin ndërkomunal dhe partneritet 30.11.2010
- 14.3. Projektligji për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale 31.05.2010
- 14.4. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për vetëqeverisje lokale 28.02.2010

#### **15. MINISTERIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL**

- 15.1. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/33 për blegtorinë 30.04.2010
- 15.2. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-8 për verëra 31.07.2010
- 15.3. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/5 për farëra 30.10.2010
- 15.4. Projektligji për shërbimet këshillimore në bujqësi dhe zhvillim rural në Kosovë 01.12.2010
- 15.5. Projektligji për pyjet 01.12.2010
- 15.6. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-9 për ujitjen e tokave bujqësore 31.03.2010
- 15.7. Projektligji për komasacion të tokës bujqësore 31.03.2010
- 15.8. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-122 për bujqësi organike 31.05.2010
- 15.9. Projektligji për kultivimin, përpunimin, produkteve dhe qarkullimin e duhanit 30.04.2010

#### **16. MINISTERIA E SHËNDETESISË**

- 16.1. Projektligji për Shëndetësi 30.06.2010
- 16.2. Projektligji për sigurime shëndetësore 31.03.2010

#### **17. MINISTERIA E PUNËVE TË JASHTME**

- 17.1. Projektligji për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare 31.05.2010

#### **18. MINISTERIA PËR KOMUNITETE DHE KTHIM**

- MKK nuk ka paraparë hartimin e ndonjë projektligji në vitin 2010



NEWBORN

